


Epidemia e kolerës së vitit 1916 në rrëfimin e Atë Anton Harapit

nga Ardian Ndreca

Tek libri *Andrra e Prëtashtit*, i botuem në Romë në vitin 1959 prej sivllaut të tij Danjel Gjeçaj, me shtypajt që Ernest Koliqi kishte marrë me vete në vitin 1943 prej Institutit të Studimeve Shqiptare, frati shirokas rrëfen një episod të përjetimit të epidemisë së kolerës së vitit 1916 në Grudë të Malsisë së Madhe...

(fq. 2)



PUSHKINI: JETA NË KOHË EPIDEMIE



(fq. 3)

POEZIA ME DY KRENA E MËRGIMIT DHE E TOKËS AMË

nga Loer Kume

Nuk e kam të thjeshtë të shkruaj për libra të tjerë. Për libra që unë lexoj. Jam një shkrimtar i thjeshtë, egoist dhe i vështirë për të komunikuar diçka tjetër mbi një libër të lexuar.

(fq. 7)

FYTYRA E DYTË E VIOLETA MANUSHIT

nga Xhevair Lleshi

Sikur të bëja një ekspozitë personale me fotot e roleve të mia, nuk do të qe keq. Pa ndonjë skemë, edhe pse ndoshta të çuditshme. I kam tmerr skemat. E di që do të vinin shumë miq e mikesha, aktorët, regjisorët dhe... Po edhe shoqet e mia të vjetra tipografe...

(fq. 11)

POETI GEORG TRAKL ANËTAR I KLUBIT 27

përzgjedhi e përktheu: Arb Elo

Shumëkush do të ketë dëgjuar a lexuar për klubin 27, radhën e trishtë të artistëve njëzeteshtatë vjeçarë që kanë ndërruar jetë në këtë moshë kaq të re...

(fq. 12)

VENDLINDJET E SHKRIMTARIT ROMEO ÇOLLAKU

nga Virion Graçi

Shkrimtarin dhe përkthyesin Romeo Çollaku e kam njohur e lexuar që në hapat e parë të karrierës së tij krijuese; libri i parë me poezi "Zemër virgjine", (1993) dallohet si miniaturë premtuese e personalitetit të mëpastajmë të autorit: ligjërimitin i zhveshur nga retorika boshe, i çliruar nga manitë e manierat, i çliruar po ashtu nga veset në modë të poetëve të rinj të asaj kohe, pra, i çliruar nga perifrazimet parodizuese, pathosi i errët deklarativ, stërpikjet banale në fjalor, etj.

(fq. 4)



ÇARLS DIKENS VËRTET, VËRTET E URRENTE ADHURUESIN E TIJ HANS KRISTIAN ANDERSENIN

nga Olivia Rutigliano

(fq. 14)

TRI VJERSHA ME NGA TRI STROFA

tregim nga

Ridvan Dibra



KËPUCËT

tregim nga

Hysen Kobellari




FJALA GËNJESHTËR
E GËNJESHTRA KUKULL
VITRINE

Ese nga Rexhep Ferri

Epidemia e kolerës së vitit 1916 në rrëfimin e Atë Anton Harapit

nga Ardian Ndreca



Ndjesia e solidaritetit që dikush ia tregon përtej çdo “conatus sese conservandi”, atij tensionit të ligjshëm që na shtyn me ruejt vetveten, ngushëllimi i fjalës së mirë, besimi se Zoti s’i ka lëshue doret, bajnë që malsorit t’i këndellet shpresa e lmekun.

Mbas disa ditësh, vijon rrëfimin Atë Anton Harapi, Lulashi i vjen në derë me një tas me qumësht në shenjë mirënjohjet, tashma kuarantina ishte hjekë prej shtëpisë së tij. Lulashi dhe njerëzit e tij e kanë marrë veten dhe asht ai vetë që spjegon gjendjen e randë shpirtnore në të cilën ishte ndodhë:

“Kurr më ngusht nuk kjeçë se atë ditë, kur m’erdhe ti, e kurr më mirë se sot nuk kam kenë. Un për veti i pata xanë të shkuem e të mbaruem, as s’isha ma ngusht për ta se për salikime të tyne; droja se po më jesin mbi dhë, as s’po gjindet kush me m’ua ba vajin as gjamën... Kemi kërcikun e vogël, morë zotni, a jo për ma tepër, por erdha sa me të pá e me t’u falë nderës me një cirkë tambël”.

Mirënjohja ma e thellë shprehet me pak qumësht, as vorfnia ma ekstreme nuk pengon kend me e shprehë këtë ndjenjë fisnike që hijeshon shpirtin njerëzor.

Rreziku ka kalue, ajo që ka mbetë asht konfirmimi i mirënjohjes ndaj françeskanëve që s’e kanë braktisë kurrë popullin e vëjtun e të izoluem të maleve tona.

Tek malsori krenar asht e gjallë edhe vetëdija se njeriu asht i pafuqishëm ndaj forcave të natyrës. Nji përvujtni e pazakontë për një mendësi që jetën e barazon me nderin dhe humbjen e këtij e cilëson si diçka ma të keqe se vetë humbjen e jetës.

Ajo që na ban përshtypje ende sot kur lexojmë këto faqe asht bindja dhe urtia e malësorit për me e pranue kuarantinën si mënyra e vetme për me i shpëtue lëngatës ngjitëse, edhe tue e dijtë se izolimi kur nuk ekzistojnë mjetet ma elementare të mbijetesës asht heroizëm dhe vetëmohim i skajshëm.

Historia e epidemive, tue nisë prej përkrahimeve të Tukididit në luftën e Peloponezitet në vitin 430 p.K. e deri më sot, na mëson se këto evente të kobshme e riformatojnë shoqnin njerzore, jo vetëm tue krijue për një farë kohe imunitet, por tue i dhanë mundësinë me kuptue ma mirë se kush jemi dhe sa vlejme! Kur njeriu e njeh njeriun nëpërmjet prizmit të frikës së një pandemie, gjithçka që vjen mbrapa ndriçohet ndryshe, disa gjana zhvleftësohen, të tjera marrin vlerën e vërtetë.

Tek libri *Andrra e Prëtashit*, i botuem në Romë në vitin 1959 prej sivllaut të tij Danjel Gjeçaj, me shtypajt që Ernest Koliqi kishte marrë me vete në vitin 1943 prej Institutit të Studimeve Shqiptare, frati shirokas rrëfen një episod të përjetimit të epidemisë së kolerës së vitit 1916 në Grudë të Malsisë së Madhe. Rrëfimi i tij ka vlerë si për me kuptue psikologjinë e malsorit që kur përhapen epidemi të atilla, ngujohet dhe s’pranon kurrsesi me rrezikue të tjerët, por edhe për me kuptue sensin e detyrës meshtarake që e çon Atë Anton Harapin me rrezikue vetveten, tue mos ngurrue me i ndejtë pranë pjestarëve të bashkësisë që janë prekë prej sëmundjes. Shtëpia e Lulashit në Pikale të Grudës asht izolue krejtësisht, aq sa edhe ujin ia çojnë fqinjët e ia lanë tek dera, vorfnia e skajshme ban të vetën, mungesa e çfarëdolloj ndihme mjeksore e randon gjendjen. Thirrjes së fratit “a don miq” i zoti i shtëpisë i përgjegjet se duhet të largohet sa ma parë prej andej se mund t’i “práhet” (ngjitet) lëngata. Atëherë Patër Antoni, që e njeh mirë psikologjinë e malsorit, e prekë në telat e krenisë:

“- Po si kështu, i thom, me t’u dhimbhtë një kafe e një cingare duhan për Fratin?” dhe malsori ia pret:

“Manà t’ishem shëndosh me rob, nuk pat me m’u dhimbët grimë as dashi i kumbonës, por mbasi Zoti, me këtë lëngatë më dau me gjith rob prej robnis tjetër, nuk ke çë bā as ti ndër né, por nisu e shko, more zotni”.


Edhe pse i pashkollë e i pashetitun, Lulashi ka një respekt të thellë për jetën e tjetrit, sa vepron kundër rregullave të mikpritjes tue ia mbyllë derën. Kuarantina për të ka një kuptim të qartë: nëse jeta jeme ka humbë të paktën mos të rrezikoj bashkësinë! Çmimi i një sakrifice të tillë asht i naltë, pse nuk ekziston asnjë strukturë mbështetëse. Vendi asht në luftë, trupat austriake, siç shkruen Dr. Kadri Kërçiku tek një monografi i mirënjohun e vitit 1962 rreth gjendjes së shëndetësisë në zonën e Shkodrës kishin ndërmarrë disa masa profilaktike, por vullneti i tyne i mirë nuk mbërrinte deri në majet e maleve shqiptare.

Mbas ngulmimit të meshtarit, ma në fund Lulashi ia hapë derën dhe e grishë

buzë votrës. Përshkrimi që Atë Anton Harapi i ban odës malsore asht ai i një paradheme të ferrit dantesk:

“Oda e tmerrshme prej vetit ishte mbushë me tym, sa me të qitë lotët prej syvet; kalamajt, të sëmuet, vikatshin sa ku mujshin, e āma, shtrī sa gjanë gjatë, mbulue me një rubë të madhe, qi s’ishte as çarçaf as batanī, gulfa-gulfa qitëte vnër prej goje me të këputë shpirtin; në një tjetër skaj të odës, një burrë kund 40 vjeç, hapë kambë e krahë, ra në kokërr të shpinës, kishte qitë sytë kokërdhok, kah dyndë vneri, donte me e qitë, e s’ishte punë me shpërthye; atje mā përtej prap një djaloç i lám në vnër, gjimonte; afër kishte të motrën, e cila, zbë në fëtyrë e bā verdhë si çapini, veç se nuk kishte dhanë shpirtin, se kishte dekë e shkue”.

Mbasi frati kryen shartet e fesë përshëndetet me të zotin e shtëpisë në derë, e ky i fundit plot miradije i thotë: “T’a dijtë Zoti, more zotni, se sot mā ke vjeftë gjysën e Pogdoricës ... se edhe me më dekë robt, tash s’po ko’ dert kurr’i grimë, kaq masht ba zemra kotec për këtë punë”.



PUSHKINI: JETA NË KOHË EPIDEMIE

Në prag të kolerës, në korrik 1831, Pletniov i shkruante Pushkinit për vdekjen e plakut Mollçanov, me të cilin ishte i lidhur shumë. Edhe Pushkini po kalonte kohë të vështira; ai vazhdonte të vajtonte për Delvigun, shokun e Liceut dhe mikun e tij shpirtëror. Ai i kishte 32 vjet. Dhe ja fjalët e ngushëllimit të që gjeti Pushkini:

PLETNIOVIT

22 korrik 1831, *Carskoe Sello*

... Letra jote e dates 19 më ka brengosur fort. Përsëri po mërzhitesh. Ej, pa shiko: mërzia është më e keqe se kolera, njëra vret vetëm trupin, tjetra shpirtin. Delvigu vdiq. Molçanovi vdiq; prit, do të vdesë dhe Zhukovskij, do të vdesim dhe ne. Por jeta gjithsesi është e pasur; do të takojmë të njohur të rinj, këta të rinj do të na bëhen miq, bija jote do të rritet, do të bëhet nuse, ne do të bëhemi pleq gërmuqë dhe gratë tona plaka gërmuqe, por të vegjëlit do të bëhen fëmijë të dashur, të mbarë, të qeshur; djemtë do të bëhen çapkënë kurse vashat sentimentale; neve na bëhet shumë mirë. Gjepura, shpirti im; mos u mërzhit-kolera vjen dita dhe shkon, të mbetemi edhe ne gjallë, do të jemi si dikur dhe të gëzuar...”


Më vjen keq që nuk i ke marrë letrat e mia. Kishte mes tyre serioze; por nuk është hatá. Eslingu, ai të cilin ti e njeh,- nip im i Liceut dhe, duket një djalë i mbarë- e porosita që të dorëzonte “Përrallat e mia”; lexoi ato për hir të mërzhisë nga kolera, nuk ka ngut për t’i botuar. Përveç 2000 për “Borisin”, s’kam marrë asgjë nga Smirdini; besoj, janë mbledhur afërsisht po dy mijë nga rroga; shkruaji atij që të m’i dërgojë me postë, duke të lënë ty 500. Me që ra fjala po të tregoj një lajm (por të mbetet, për shumë arsye, midis nesh): cari më ka marrë në shërbim - por jo në kancelari, apo pranë oborrit, apo në ushtri-jo, ai më ka dhënë rrogë, më ka hapur arkivat, që të gërmoj atje dhe të mos bëj asgjë. Një mirësi shumë e madhe nga ana e tij, apo jo? Ai tha; “Puisqu’il est marié et qu’il n’est pas riche, il faut faire aller sa marmite.”[Me që është i martuar dhe jo i pasur, i duhen dhënë mjete për të jetuar.] Me të vërtetë që është treguar shumë i mirë me mua. Po kur do të shihemi, vëlla? Oh, kjo kolera tani! Jusupovi im vdiq, Hvostovi ynë vdiq. Me shpresë se vdekja do të kënaqet vetëm me ato dy viktime. Lamtumirë. Shumë të fala. Qofshi me shëndet. Krishti me ju.



PO CILI ISHTE PLETNIOVI

Pjotr Aleksandroviç Pletniov është një nga poetët e shumtë të kohës së Pushkinit, kritik dhe botues. Gjithashtu, mik i Pushkinit dhe ndihmësi i parë e tij në çështjet letrare. Ato u njohën shumë kohë para se Pushkini të përfundonte Liceun. Letërkëmbimi i tyre është përplot me çështje letrare, botimi, financimi, praktike dhe çdo gjë tjetër. Ai ishte për Pushkinin “gjithçka: dhe i afërm, dhe mik, dhe botues, dhe arkëtar”. Ai nxori në dritë- që do të thotë gjeti botues dhe librashitës, zgjidhi çështjet tipografike, materiale dhe probleme të tjera, për më shumë se 20 libra të tij. Dhe të gjitha këto pa asnjë interes. Pushkini e quante Pletniovin “mëndeshë”, “bamirës” dhe e pranonte që për pavarësinë e tij “i detyrohem Zotit dhe ty”. Si akt mirënjohjeje nga ana e tij, Pushkini i kushtoi Pletniovit kreun IV dhe V të romanit në vargje “Eugjen Onjegin” [1828] dhe më vonë- të gjithë romani [në 1833, kur doli botim i veçantë.]

Përgatiti dhe përktheu B. Hudhri



VENDLINDJET E SHKRIMTARIT ROMEO ÇOLLAKU

nga Virion Graçi

Shkrimtarin dhe përkthyesin Romeo Çollaku e kam njohur e lexuar që në hapat e parë të karrierës së tij krijuese; libri i parë me poezi “Zemër virgjine”, (1993) dallohet si miniaturë premtuese e personalitetit të mëpastajmë të autorit: ligjërimin i zhveshur nga retorika boshe, i çliruar nga manitë e manierat, i çliruar po ashtu nga veset në modë të poetëve të rinj të asaj kohe, pra, i çliruar nga perifrazimet parodizuese, pathosi i errët deklarativ, stërpikjet banale në fjalor, etj. Poezia e tij ishte e është rrëfim i qashtë artistik, vëzhgim i ndërë minimalist, ndjenjë e mirëfilltë lirike e shpërngulur në mendjen e lexuesit nëpërmjet gjetjesh të përkora, me hollësi simbolizuese, me fragmente domethënëse nga mozaiku i madh i kaosit epik të jetës sonë. Këto karakteristika mbarten, pasurohen e theksohen më tej në librat e tjerë me poezi: “Gjithë diell e natë” (2003); “Kumbaraja e kohës” (2004); “Heshtjen duke gërmuar” (2011); “Vise kundërmime” (2013). Por, Romeo, si shumë krijues të tjerë të talentuar e të pasur në mendim, u ndie ngushtë brenda mundësive shprehëse të poezisë si zhanër letrar; libri i tij i dytë ishte romani “Varrezat e vendlindjes” (2003), ndërsa libri i tij më i fundit është po ashtu një roman – “Mjalt në teh” (2016).

Proza e tij romanore, bashkë me vëllimin e suksesshëm me tregime “Për shtegëtarët e pak metrave katrorë” (2009) më ka nxitur shpesh të mendoj për to. Te secili autor original priremi të hetojmë çfarë bote të re, të panjohur, të figurshme ka ndërtuar; te prozat e R. Çollakut kemi përherë një kthim të fuqishëm, prekës, përndrues e delikat në vise të njohura të zanafillës njerëzore, në mjedise e formacione shoqërore ku era standardizuese e riformatimeve urbane-kulturore nuk e ka fshirë, nuk e ka marrë me vete karakterin e personazheve, botën e tyre shpirtërore, gjuhën e tyre të përditëshme, strukturat e të menduarit e të shprehurit, sikurse, ka shpëtuar, është ruajtur edhe skena natyrore ku luhet drama spektakli i përditëshëm i jetës zë zakonshme. E thënë ndryshme, R. Çollakut i është bërë zakon ta çojë lexuesin në vendlindjet e tij shpirtërore, në burimet e tij të ëndërrave, zhgënjimeve, zbavitjeve; nëse ka shkrimtarë që shkruajnë duke parë me sytë e mendjes nga e nesërmja, Romeo shkruan me sytë e shpirtit e të kujtesës, i përqëndruar deri në makth në jetën e jetuar dikur, viteve të pafajësisë e të ndjeshmërisë fëminore. Mbase kjo e bën prozën e tij të shquhet, të jetë e dashur, e këndshme dhe e kujtueshme, njëkohësisht.

Romani “Mjalt në teh” është më domethënësi sa i përket vëzhgimit tonë të mësipërm: një fshat i jugut të Shqipërisë rrëfëhet në kapërcyell të dy epokave, nga muajt e fundit të L2B deri në mesin e viteve 60 kur Shqipëria, me urdhër nga kupola e pushtetit diktatorial, u bë i pari dhe i vetmi vend ateist në botë, i mbylli objektet e besimeve fetare: kisha, xhami, teqe.. Fshati i romanit “Mjalt në teh” ngjan një ishulli në brendësi të të cilit nuk depërton asnjë ideologji e re, asgjë zhargon bashkëkohor politik, asnjë formë ‘e re’ e jetës së re që ka përfshirë mbarë atdheun e atëherëshëm socialist; kuptohet, jeta ndryshon në sipërfaqe, pushteti i ri i krijon teologët e tij, tellallët e tij e normat e reja të organizmit shoqëror, por kjo i ngjan një inskenimi teator, i ngjan një farse të cilën banorët pranojnë ta lozin seriozisht nga fillimi në fund, pa u dashuruar me rolin që u është caktuar arbitrarisht, pa u konfrontuar me “regjisorin” fuqiplotë të shfaqes, me regjimin e ri. Poshtë petkave të reja, banorët e fshtatit ruajnë me fanatizëm e inerci shekullore format e shprehjet tradicionale në perceptimet e tyre lëndore e botëkuptimore: toka, kisha, ritualet individuale të jetës vetjake, nga lindjet, pagëzimet, martesat, deri te vdekja, të tëra nën hijen dhe nën hirin e kishës e të kumbanores së saj..

Më gjatë ndalemi kësaj here te romani i tij i parë, i njohur si “Varrezat e vendlindjes,” në botimin e parë (2002) dhe ribotuar e qarkulluar më së miri katër vite më vonë me titullin “Ar e fosfor.” Pëlqej t’i drejtohem me emrin e parë: “Varrezat e vendlindjes” *risjell* në letërsinë shqipe ballafaqimin me botën e varreve, me pasvdekjen fizike te njeriut. Themi e *risjell* sepse fshirjen e kufirit midis jetës dhe vdekjes, botën e varreve me të gjitha ngarkesat dhe efektet e saj etiko – emocionale e gjejmë jo rrallë në letërsinë tonë, si në letërsinë popullore edhe atë të kultivuar. Nga letërsia popullore janë të shumta përrallat, këngët, baladat me temë pasvdekjen ose mardhënien midis të gjallit dhe të vdekurit; nga letërsia e kultivuar do të përmendim dy autorë përfaqësues: Mitrush Kutelin dhe Ismail Kadarenë. I pari, Kuteli në disa tregime të mrekullueshme e ka përdorur mjeshtërisht pranëvënien jetë tokësore – jetë e amëshuar; i dyti, Kadare pafundësinë e kohës astronomike e ka antropologjizuar duke i projektuar në jetën e përditshme të njerëzve të gjallë

në disa vepra, sikurse ndodh në mënyrë më të drejtpërdrejtë te romanet: “Kush e solli Doruntinën”, “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “S.P.I.R.I.T.U.S”, “Pasardhësi”.


Në krijimet e Kutelit dhe të Kadaresë prania e të vdekurit, prania e njeriut te vrarë ose bota e përtej varrit në përgjithësi krijon vatra sematike të fuqishme, ndjeshmëri dhe simbolika te veçanta. Te proza e R.Çollakut ky proces pranë vënës dhe ballafaques nuk e koncentron ndjenjën dhe nuk i sofistikon përfytyrimet metafizike për jetën e përtejme, përkundrazi: ky realitet qënësor dhe imagjinar njëkohësisht, përherë rrëqethes dhe enigmatik gradualisht ç’tensionohet, natyralizohet hap pas hapi duke u shkarkuar nga ngarkesat emocionale dhe nga simbolikat e njohura deri më sot në letërsinë shqipe. Për nga mënyra e procedimit artistik vlera e romanit qëndron te animizimi konvencional i ambientit, i vendit te veprimit, kurse shuarja e kontradiktës midis thelbit njerëzor të heroit dhe rrethanave ç’njerëzore në të cilat ai detyrohet të përfshihet e të veprojë përditë për të mbijetuar fizikisht - sjell një dukuri të re në romanin shqiptar: estetizimin e negativitetit njerëzor.

Estetizimi i negativitetit.

Te *Varrezat* personazhi kryesor i quajtur Çiraku ndërmerr një udhëtim pune në vendlindjen e tij bashkë me Ustain. Ecin të heshtur, përkrah njëri – tjetrit. Errësira, ftoma, shiu, shpellat janë pjesë të pandashme të udhëtimit të tyre.

Nga jeta e Çirakut mund të nënvizojmë këto ngjarje: në fëmijëri ë përzënë nga fshati për hapjen e një varri; bëhet ndihmës i një vjdhësi varresh në një vend të huaj; pushtohet nga malli i fortë për vendlindjen; gënjen Ustain dhe bashkë me të kthehet në vendlindje; ballafaqimin me të kaluarën nuk e përballon dot. Shoku i fëmijërisë ka vdekur. Nuk takon askënd. Dritat e shtëpisë së tij i duken të ftohta dhe armiqtësore; nga ky udhëtim ftohet dhe vdes, mjaft i ri në moshë; te vendi ku varroset sipas porosisë së tij nuk i vihet ndonjë shenjë dalluese.

Paraqiten pra dy personazhë me veprimtari të jashtëzakonshme në kuptimin negativ të fjalës. Ustai jepet si figurë plotësuese, me një rol dekorativ për shkak të bashkëpunimit profesional me Çirakun. Çiraku është heroi problematik i romanit. Figura e tij zbulohet shkallë-shkallë dhe përkundër punës së neveritëshme me të cilën merret, nuk perceptohet negativisht në atë masë sa do të mund të ndodhte në kushte normalë. Dy lëvizje dallojmë te ky personazh, të dyja të mishëruara



Virion Graçi

qartë e të kundërta mes tyre në planin etik. E para lidhet me përditshmërinë, me punën për sigurimin e mjeteve materiale të jetesës: udhëtimet e lodhëshme me veglat në shpinë, shtegëtimet e gjata e të rrëzikshme përkrah Ustait, plaçkitja e varrezave. Lëvizja tjetër është shpirtërore dhe në kundërshtim të vazhdueshëm me veprimtarinë e jashtëme. Kjo lëvizje vjen duke u theksuar, luan rolin e një rezistence pasive e cila përparon gradualisht në kahun pozitiv. Dhe romani nis në çastin kur personazhi vepron i kushtëzuar nga pjesa e mbetur e ndërgjegjes. Formalisht është me Ustain si në ndërmarrjet ë mëparëshme por së brendëshmi përgatitet të ndahet përgjithmonë me gjithçka, jo vetëm me profesionin. Në fundin zhgënjyes të udhëtimit të shumë ëndërruar Çiraku, shpirtërisht duket se po ndahet edhe me vëtveten. Vdekja e parakohëshme i ngjan vëtvrasjes – aq shumë është shuar te ai dëshira për të jetuar – aq shumë është ndezur te ai dëshira për tu ndarë nga koha e tanishme e ekzistencës. Tanimë zanatin e dënueshëm e shfrytëzon për të nxjerrë nga varri të kaluarën e tij prej njeriu normal.

Koha e tashme e ekzistencës i nënshtrohet të kaluarës nëpërmjet përjetimit të fuqishëm të kujtimeve fëminorë, gjithashtu e tashmja i nënshtrohet përfytyrimit të së ardhmes prej vdekatare të rëndomtë. E shikon veten shpesh të shtrirë në varr dhe sipër gropës imagjinon një vjedhës varresh. Në ëndërr i shfaqet lumi i Karontit, varka që shtyn për më tej shpirtat e vdekur.

Me mjeshtëri autori e ekspozon Çirakun në stacionin e parafundit të jetës tokësore duke ia vënë në provë thelbin njerëzor. Duket se fillon të refuzojë negativitetin e jashtëm, ka energji të mjaftueshme për tu tërhequr në thellësitë e pandotura të qënies, por nuk ka fuqitë e duhura dhe nuk motivohet dot për të nisur një ekzistencë të re. Ndërgjegjësimi për papërfillshmërinë e jetës tokësore kundrejt përjetësisë si dhe bindja në pamundësinë e rezultateve të pëlqyeshme për një raport të ri me njerzit e tjerë i'a kushtëzojnë sjelljen. Ekzistenca reduktohet në një qëllim të vetëm dhe final: ta rijetojë edhe një herë atë periudhë, para se ta dëbonin nga familja, nga shokët, nga vendlindja. Për këtë arsye të vetme kthehet duke nxjerrë si shkak varrezat e vendlindjes. Situata ngjan paradoksalë. Autori duket se kërkon të pamundurën nga heroi. Sprova krijuese kalohet me sukses – e jashtëzakonëshme, e pamundura natyralizohet nëpërmjet digresioneve të cilat shpjegojnë dhe arsyetojnë deri diku metamorfozat e çuditëshme të Çirakut. Fëmijëria e tij ka përkuar me sundimin e Gavrilëve të cilët në tre breza shkaktojnë mjerim të padurueshëm. Vdekja e Gavrilit të tretë ia ndryshon jetën Çirakut sepse duke parë trupin e tij të pavarrosur e të mbushur me qindra stoli e unaza floriri, bie në tundimin për t'ja vjedhur pasuritë kufomës. Kjo lloj revolte paraprihet nga një marrdhënie direkte mes familjes së Çirakut dhe sundimtarit; pra, çiraku fëmijë kërkon t'i marrë sundimtarit pas vdekjes ato pasuri të cilat në të gjallë sundimtari iu kish rrëmbyer fshatarëve duke i rrënuar me gjithçka. Digresionet në rrëfim sipas rastit plotësojnë të tashmen ose e theksojnë atë nëpërmjet kontrastit. Në përfundim të historisë kemi këtë dialog:

-Çirak, ke rënë në të thella? – e pyeti Ustai.

-Mendoj për atë peshkatarin – tha ai – për atë peshkatarin që u mbyt dhe kurrë nuk iu gjet trupi. Vetëm valët e detit ia trazojnë eshtrat.

Ky dialog tregon si kurorëzohet te Çiraku lëvizja e tij shpirtërore: nga një dhunues eshtrash deri pak më parë tani pikëllohët për eshtrat e një të panjohuri – duke lënë pas dore kujdesin për vetveten, duke lënë mënjane pikëllimin për jetën e tij e cila dukshëm fillon ti venitet përpara syve me shpejtësi fatale. Duket se është pajtuar me fatin e tij ndonëse s'ka jetuar si njeri po vdes si i tillë, dhe atij për të qënë i ngushëlluar kjo i mjafton.

Animizimi konvencional i mjedisit.

Vend të rëndësishëm në “Varrezat e vendlindjes” zë animizimi konvencional i mjedisit dhe funksionet të cilat ai kryen. Animizimi i mjedisit në një masë të përfillëshme e bën të panevojshëm karakterizimin e personazheve me mjetet tradicionale të zhanrit. Nga përshkrimet e jashtëme dhe nga rrëfimet e brendëshme të tyre mbeten të panjohura për ne përmbajtja e personazheve, mbeten të panjohura edhe raportet që krijojnë ata me vetveten e botën përqark. Portretizimi i bërë nga kënvështrimi i një fëmije që ata takojnë udhës mbetet i vetmi portretizim, i pandryshueshëm, dhe i vlershëm deri në fund: *në fytyrat e dy udhëtarëve, në veshjet, në pajimet dhe në ecjen e tyre asgjë nuk binte në sy si e pazakontë. Asgjë nuk i bënte të frikshëm. Fytyrat e tyre fëmija i hetonte pa vështirësi - nuk shkërbenin keqbërësin. Thjesht shprehnin lodhje.*

Ustai e Çiraku jepen skematikisht si personazhë që lëvizin në mënyrë mekanike. Fjalët që shkëmbejnë dhe gjetet që kryejnë nuk zbulojnë origjinalitetin e tyre. Bisedat, monologët si dhe përshkrimet e autorit në lidhje me ta kanë fakte jo domethënëse. Dukët sikur nuk zotërojnë asnjë cilësi – ndërkohë përcaktues dhe domethënës bëhet vendi i veprimt, ambjenti ku ata duken sipërfaqësisht. Ambjenti animizohet duke marrë përsipër funksione të përqëndrimit dramatik e të dendësimit kuptimor. Ambjenti i animizuar mbi bazën e disa konvencioneve krijon vatra ku konvergjojnë lëvizjet, ndjesitë dhe simbolet e veçanta.

Së pari:–është konvencioni i shpirtit të vajzës i cili i korenspondon fëmijërisë



Romeo Çollaku

fatëkeqe të Çirakut, parajsës së humbur, lumturisë pa kthim: *Kjo shtëpi e braktisur, e banuar nga hije të kërrusura, ishte vendlindja e Çirakut... Aty më poshtë, në fund të asaj rruge, në shtëpinë e fundit të fshatit kish jetuar mikesha e tij e fëmijërisë... Një ditë (dita e balonave) ajo i la në duar shpirtin e saj dhe i tha: Merre. Shikoje me kujdes. Dhe pastaj bëj ç'të duash më të. Iku. Ai e mbante shpirtin e saj në duar dhe e vëzhgonte me kujdes. Shpirti ishte i vogël, i bardhë. Ç'mund të bënte më të? Meqë ishte dita e balonave, balonë e bëri dhe e nisi në qiell.*

Së dyti:–është konvencioni i fustanit të kaltër i cili i korenspondon fatit të bukurisë dhe të dashurisë në një kohë dhe në një vend të përcaktuar tashmë: çdo pranëverë në fshat flladi sillte fustanin e kaltër të një vajzë të vdekur. Kjo ndodhte në krye të stinës, po të njëjtën ditë kur skutave kundruall spikasin vjollcat e sapoçelura. Fustani thuhej vinte nga larg, nga një zabël dushqesh rreth 4 a 5 ditë larg fshatit.

Më poshtë tregohen Ustai e Çiraku: *ja ku ishin tani duke u çapitur, me atë ecje tejet të ngadaltë, në rrugën e fustanit të kaltër”.*

Së treti: – është konvencioni i uturimës i cili i korenspondon një jetë tepër të varfër: *kur ia behu muaji i të korrave, në fshat filloi llahtara: nga ara filloi të vinte një rënkim i zgjatur, i njëtrajtshëm, therës, i fortë si uturimë, ishte natë.*

Së katërti:–është konvencioni i varrezave të Dëshmorëve të Idealit Kombëtar i cili i korenspondon bjerres morale e historike në një etni të caktuar : *nuk gjetën asnjë send të çmuar në varrezat e Dëshmorëve të Idealit Kombëtar. Gjetën medaljonët e kallajtë të matrikujve që as numurat nuk u shqueshin më. Gjetën helmata, bajoneta e gaveta të ndryshkura.*

Së pesti:–është konvencioni i lumit të Karontit i cili i korenspondon mallkimit të përjetshëm, dënimit me vetmi të pafundme sikurse mëson Çiraku se ai vet është i shënuar nga fati–as në varkën e Karontit nuk ka vend për të. Karonti zemërohet me Çirakun, currila gjaku i burojnë. Ai thotë: *nuk mund ta nis varkën për dy vetë.*

Së gjashti:–është konvencioni i dy vëllezërve binjakë, Gëzimit dhe Trishtimit. Nga vëllezërit binjakë mbetet gjallë Trishtimi, kurse Gëzimi vdes para kohe sikurse çdo gjë e mirë dhe e bukur shkatërrohej krejt dhe mbulohej me baltë në atë fshat.

Në vepër ka konvencione të tjera funksionale, të një rëndësie më të vogël. Do të donim të nënvizonim faktin së animizimi i mjedisit në “Varrezat e vendlindjes” shndërrohet në parim krijues duke luajtur rol parësor në organizimin kompozicional të veprës. Nëpërmjet tij, ngjarja bazë e romanit – gjendja e Çirakut – në mënyrë të koncentruar, nga faktografi e një jete të zyrtë individuale imponohet bindshëm duke u shpalosur si metaforë e një jete kolektive.

Në vend të përfundimeve: autori është njëkohësisht dhe përkthyes i talentuar, i përkushtuar. Çdo vit i dhuron lexuesit tonë disa qindra faqe letërsi të përzgjedhur nga bota letrare: romane, poezi, tregime me të cilat shfaqte njëjtin përkushtim gjuhësor e saktësi të ligjërit artistik, sikurse edhe në krijimet e tij. Qysh tash, për nga sasia e librave të përkthyer, për nga rëndësia historike, letrare-estetike e veprave të përkthyer, Romeo e ka merituar një vend mes përkthyesëve tanë të dalluar. Por, duam të ketë më shumë kohë për veten e tij, vendlindjet e tij letrare janë të pasura, të begata. Ato presim me padurim të vijnë në skenën e prozës shqipe nëpërmjet penës së R. Çollakut.

1.

Për të parë ose lexuar kurrë nuk kemi qenë më shumë.
Kurrë nuk kemi qenë më larg dhe më të vetmuar.
Dhe kurrë nuk i kemi ngjarë më pak vetvetes.
Sot kjo rrugë qenka e vetmja rrugë dhe e vetmja kohë.
Prandaj s’duhet të mendoj shumë se çmendem.
As në bisht të sorrës nuk ka mbetur vend as për gënjeshtër.
Me jetën që kemi, çka të bëjmë?
Për histori nuk kemi kalendar.
As vite.
As shekuj.
Nuk kemi bërë asgjë dhe nuk po mendojmë asgjë.
Të shohim kush jemi dhe çfarë lajme ka.
Ëndrrat na kanë lënë vetëm.
Mos u shqetësoni!
Dikur ndoshta ia dalim.
Deri dje ka qenë natë.
Për të qenë më të kuptueshëm a ka hero?!
A është një apo njëmijë e një?!
Ku i kemi sytë?
Emrat?
Nënshkrimet?
Fillimin në tokë?
Vazhdimin në qiell?
A mund ta kuptojmë pse?
Dëshiroj të shkoj te shtatorja e heroit të panjohur për të bërë një fotografi.
Fotografi?
Një fotografi që të më bëjë shoqëri kur jam vetëm.
Ta kuptoj se jam gjallë.
Mikut dhe armikut nuk i bëhet vonë.
Në këtë botë jetohet edhe pa Zot.

2.

Jemi ashtu si jemi.
A mund të shkojë më keq?
E nesërmja ndoshta nuk vjen.
Kur flasim për njeriun a jemi të besueshëm?
Pse të gënjej!
Ndoshta nuk ka kuptim.
Le të del ku të del.
Pse fshihemi?
Historia gjithmonë shihet si një hapësirë e pushtuar, apo si një hapësirë e lakmueshme për ta pushtuar.
Tani jemi duke e bërë një pushim.
Njeriu jeton dhe nuk e di ku dreqin do të shkojë dhe nuk e di se çka e përcjell deri te Guri i Varrit.
E vërteta harrohet shpejt.
Heshtja nuk ndryshon asgjë.
Kur fillon, fillon.
Kur mbaron, humb.
Me sentimentalizëm e shohim vetëm një ëndërr.
Për sekrete çdo i çmendur e ka theksin e vet.
Fatmirësisht që nuk është Zot.

3.

Më 1971 e 1972, si Zogu Përrallor që digjet dhe rilind nga hiri i vet, prapë shkova në Paris.
Në rrugën Fi-Fi, në kafenenë Kyzhas me një studenteshë franceze për herë të parë e piva një kafe.

- Nga jeni?- më pyeti.
- Nga Shqipëria.
- Ju qenkeni nga vendi i Ismail Kadaresë.
- Po!
- A jeni edhe ju shkrimtar?
- Jo!... Dhe, nuk e di!... Kombit tim i mungon një piktor i mirë.
Ajo me një buzëqeshja të hollë e të qetë e vazhdoi rrëfimin.
- Gjatë Vjeshtës Kulturore në Paris edhe Xhon Mili ka hapur një ekspozitë të fotografive. Në atë ekspozitë, në atë ambient për mua të panjohur kuptova se edhe Xhon Mili ishte shqiptar. Në atë ekspozitë për herë të parë e kam parë edhe Pikason duke vizatuar me dritë. Ajo që pashë në atë ekspozitë kishte më shumë dritë natyrale se artificiale. Kjo

mëdha tragjike”.
Gjatë një rruge ku nuk ka pasur rrugë, në legjendat tona vëllai për motrën bëhet valë deti.
Aty për aty harrohet realiteti.
Motra për vëllanë çdo ditë kah sillet e kah shkon vetvetes i thotë: “Ai nuk është në mes të vdekurve! Ma ka dhënë fjalën që vjen me më marrë...”
S’është për të mos besuar.
Për motrën vëllai i vdekur është jetëgjatë.
Këtij rrëfimi edhe nëna fatmjerë i beson.
Për të treguar madhështinë e rrëfimeve, të legjendave në fushë të mejdanit motrës i ngjallen shpresat.
Për të besuar ka shumë hapësirë të zbrazërt brenda vetes.

Flasim për detin.
Ndalemi.
Shqetësimi na vjen nga vetvetja.
Dhe prapë bjen mjegulla.
Ashtu si di ajo vetë.
Për kohën e harruar.
Përtej mundësive tona diçka e largët, prapë është e largët.

6.

Për marrëzitë tona, pse jemi kaq të etur e të pangopur e të trishtueshëm?
Lapsi i moralit njerëzor nuk ka lënë asgjë të shkruar.
Për historinë e përgjimit s’kemi çka të flasim.
Nga jeta nuk kërkojmë atë që e njohim, por atë që ende e kemi të panjohur.
Imagjinata na bën kërkues.
Nëse nuk je i ftuar, nuk ka kuptim as të shkosh e as të ndalesh.
Po thonë e po flitet se humbja e identitetit nuk është gjë e madhe.
Kryqi i një kryqi.
E shohim kur e harrojmë.
Fjala bëhet gënjeshtër e gënjeshtër kukull vitrine.
Kur dritat artificiale ndryshojnë nga fjalët e pabesueshme dallimet nuk i kuptojmë.
Shumë gjëra i kemi në rrafshin e numrave 1,3,4,5.
Kjo ndjenjë nuk krahasohet me asgjë që e kemi të njohur.
Sot e kemi një shpejtësi që nuk do as ëndrra, as dashuri.
Momentet e mëdha lindin shpejt.
Pritet të jemi edhe më të çmendur.
Përtej murit, pa ndalesa e pa kufizime, ajo që dimë është pak.
Ajo që shohim është një mur mbi mur.
E shohim të gjithë.
Kujt i duhet ndryshe?!
Sot çmenduria njeriun e bën të lumtur.

7.

Ku të shkoj?
Ku të ndalem?
- Ndryshoje identitetin, - më thanë.
– Fytyrës futja tri operacione plastike.
Kërkush nuk të njeh. Kurkush nuk të shanë. Qebesa, kërkush as nuk të qanë.
Pa familje e pa Atdhe nga e kaluara s’kemi as çka të lëmë e as çka të marrim e as çka të harrojmë.
Në sekretet e panjohura nuk po shkoj më larg.
Realizmi politik është një mashtrim i madh.
Me lajme të rrejshme.
Me fjalë të pabesueshme nuk po shkoj më larg.
Veç me kris Lufta e Tretë Botërore.
Jo sot, po nesër!
Jo patriot, po tradhtar.
Është marrëzi se dikush mendon se do të bëhet mirë.
Fundi i mjerimit qenka i gjatë.
As çka të marrim e as çka të lëmë.
Në hapësirën e së jetuarës, vepra e jetës qenka maskë mashtruese.
Kështu mbaron muhabeti.
Nuk them asgjë me këtë.

Për besimin e shenjtë, gjatë atyre sekondave të fundit të jetës, para vdekjes s’ka kuptim ta gënjejmë veten.

Shkurt, 2020

FJALA GËNJESHTËR E GËNJESHTRA KUKULL VITRINE

Ese nga Rexhep Ferri



Alen Boske në ekspozitën e Rexhep Ferrit në Paris më 1977

ide a mund të jetë e njëjta dritë për të gjithë? – më pyeti.
Unë duke kërkuar vetveten, pas një pushimi të shkurtër i thashë:
- Jeta nuk është si tregimet e “Një mijë e një netëve”.
Në të njëjtën kohë ka shumë kërkesa dhe fjalë të pakuptueshme.
Studentesha që më foli për Ismail Kadarenë e për Xhon Milin, quhej Barbara nga Ishulli.

4.

Pesë vjet më vonë, më 1977, në Galerinë e babait të saj, në Paris unë e hapa një ekspozitë.
Për atë prezantim të pikturave të mia Alen Boske (poet i njohur francez) ka shkruar:
“Ajo që mua personalisht më tërheq te Ferri është një përpjekje për të paraqitur shkatërrimin, pastaj rifillimin e botës përmes vështirësive të

5.

Patriotët tanë sojli gjatë gjithë kohës janë në hap me kohën.
Lugën e çojnë vetëm në gojë të vet.
Jetën shpejt e kanë kuptuar.
Nga lakmia e kanë harruar frikën reale.
Mirë është që nuk kërkohet një vrasje.
Për të larë duart ndoshta nuk shkohet më larg.
Kur bota e vogël mbyllet në botën e madhe njeriut me fytyrë gozhda i ngulet në zemër.
Për fajin e vet dhe mikut mashtrues.
Vonë e kupton se bota e vogël e mbyllur në botën e madhe shpesh e ndërron mendjen.
Pa na njohur na bind se jemi të pranishëm.
Kur mendojmë se është humbje kohe duhet të jemi me fat.
Kur ndodh diçka që është e shkruar, me gjysmën e çmimit bjen mjegulla.

POEZIA ME DY KRENA E MËRGIMIT DHE E TOKËS AMË

nga Loer Kume

Nuk e kam të thjeshtë të shkruaj për libra të tjerë. Për libra që unë lexoj. Jam një shkrimtar i thjeshtë, egoist dhe i vështirë për të komunikuar diçka tjetër mbi një libër të lexuar.

Por të shkruaj për *Enciklopedinë e Mërgimit* është një shtysë po aq e fortë sa të shkruaj një tregim apo një pjesë romani.

Enciklopedia e Mërgimit më thërret. E dua të them dy fjalë mbi një libër në vetvete *double*. Të munguar, e të arritur, një libër plot me dualitete.

Do doja të krenohesha që miqtë e mi të zgjedhur shkruajnë poezi të mrekullueshme që të transportojnë në udhëtime e fluturime magjike.

Por, e vërteta është se poezia na bëri miqtë e sotëm, edhe para gotës. E para ishte poezia.

Autorët e *Enciklopedisë* i kam njohur fillimthi prej vargjeve e metaforave të tyre. Shtizat e Shqiptarit, e retë e valët e Entelës, dhe jam mahnitur me poezinë e tyre. Të dy janë shkrimtarë që i kam njohur në rrjet, dhe ata të dy, si dhe disa të tjerë endeshin rrjetit duke krijuar, postuar, ushqyer ngadalë audiencën me poezinë e tyre, e cila na lidhi, na bëri të njohur, e sot miq të mirë. Sepse poezia e Entelës, Shqiptarit, dhe disa të tjerëve që pak janë botuar, e enden ende rrjetit, është pjesë thelbësore, zemër

e mozaikut të poezisë së brezit tonë. Një poezi krejt e re.

Dëshira ime më e madhe, pasi kam udhëtuar me vargjet e lira të Shqiptarit e ritmet e Entelës, ka qenë t'i shihja këta dy autorë të botuar në libra të prekshëm, që u bëjnë nder cilësive të dy autorëve, të botuar para publikut të gjerë poezidashës. Këta poetë duhet të zinin vendin e tyre në letrat shqipe e më gjerë. Por, kurrë nuk e kisha imagjinuar që dy poetet do kishin çmendurinë krijuese të të botuarit një libër të dy bashkë. Dhe këtu lind Libri-koncept. Libri me dy krena. *Enciklopedia* është një libër me dy gjuhë. Titujt anglisht, e poezitë në shqip.

Titujt janë thelbësisht prozaikë, shpjegime fjalori termash që kanë të bëjnë me migrimin. Poezitë që janë përputhur sipas temës të secilës poshtë titujve, janë një gurrë lirike magjike, në raporte perfekte midis metaforave poetike dhe nervit të mendimit.

Poezitë është zgjedhur të jenë pa emër autori. Ato janë një vallëzim fantastik midis dy gjuhëve, gegnishtes gurgullitëse të Gjakovës, e asaj fluturuese të Shkodrës. Një vallëzim midis një mashkulli e një femre. Një burrë e një grua të lidhur filli nga vargjet. Një dualitet vallëzues midis temave të dashurisë së atdheut, dhe arratisjes nga atdheu.

Një dualitet e vallëzim midis Shqipërisë e

Kosovës.

Një dualitet katodë anodë midis botës Shqiptare, dhe asaj Suedeze.

Një duel midis frikës për të lënë atdheun, e dyshimit të arratisjes në një dhe të ri, me ngjarje të reja e jetë të re që të pret. E një duel midis frikës për të ndenjur në atdhe, e ngazëllimit të njohjes e mbjelljes së farave të tua në një tokë të re.

Enciklopedia e Mërgimit është një koncept që mban e përkund brenda mërgimin, si arratisje brenda vetes, e atë mërgimin nëpër botë. Një libër mbushur me duele, vallëzime, dualitete, paradokse, e dashuri.

Jam shumë i kënaqur që sot jam përballë faktit, materializimit të dëshirave të mia për një libër të miqve të mi, e poetëve fantastikë të brezit tonë, e kjo kënaqësi më shtyu të shkruaj dy fjalë mbi librin e tyre, poezinë e tyre, se çdo krijues meriton të dëgjojë fjalët lëvduese mbi punën e tij kur këto fjalë rrjedhin natyrshëm e vërtetë. Dhe se e quaj ogur të mirë të një rilindjeje të poezisë shqipe, e cila me vite nuk e ka pasur dritën e skenës sipër. E quaj një hapje dyersh të botimeve të poetëve të kësaj kohe, të ditëve ku jetojmë, me mendimin se vetëm poezia e vërtetë dhe shkrimtarët e artistët do e shpëtojnë këtë vendin tonë të vogël të madh, të mjerë e ndriçues, me dy krena.

29.02.2020



TRI VJERSHA ME NGA TRI STROFA

tregim nga

Ridvan Dibra

Duhet të kem qenë në klasën e gjashtë, diku rreth moshës 11-12 vjeç, kur në revistën e atëhershme “Pionieri” më janë botuar tri vjershat e para. Të tria me nga tri strofa, të vendosura në anën e djathtë të faqes, nën njëra-tjetrën. Edhe tani i kujtoj titujt dhe renditjen:

1. **FSHATI** (tregonte për një fshat të bukur e të lumtur, edhe pse kurrë s’kisha qenë aty).

2. **PARTIZANËT** (nxitur nga filmat e parë dhe librat e lexuar me këtë temë).

3. **GJYSHI** (i kushtohej gjyshit tim, edhe pse ai kishte vdekur shumë kohë pa lindur unë).

Kurse sipër tyre, me germa pak më të vogla se ato të titujve, emri im: **RITVAN DIBRA**. Edhe pse i shkruar gabim, ngaqë duhej RIDVAN (një gabim i tillë përsëritet shpeshherë dhe sot e kësaj dite), ai ishte emri im. Nuk e luante as topi! Përderisa vjershat poshtë tij ishin të mijat. Bile i dija përmendsh. Të tria. “*Fshati im i dashur / fshati im i ri...*”, fillonte e para.

Lajmin e botimit të vjershave do të ma jepte i pari mësuesi i gjuhës dhe i leximit letrar, një burrë i zeshkët e i sertë, prej portretit të të cilit kujtoj mustaqet e zverdhura nga tymi i duhanit. (Me të mbaruar ora e mësimit, fill e vinte në buzë cigaren e radhës, të cilën kurrë s’e çonte deri në fund, ngase pushimet mes orëve nuk zgjatnin më shumë se pesë minuta.) Në të gjithë shkollën ishte i vetmi mësues që mbante mustaqe, fakt ky që para nesh e bënte *më ndryshe* e më të frikshëm nga mësuesit e tjerë; bile dhe se ai i aritmetikës.

Edhe tani e mbaj mend futjen e tij *atë ditë* në klasë. Kishte hyrë më herët se zakonisht, disa minuta pa rënë zilja e orës së mësimit. Në dorë mbante një tubë revistash, kurse ndër sy e përreth mustaqeve i shëtiste një qeshje e lehtë, të cilën rrallëherë ia kishim parë. Ende pa u ulur në tavolinën e tij, më kishte urdhëruar të ngrihesha në këmbë dhe të dilja para klasës. Edhe pse aty për aty nuk po kujtohesha për ndonjë faj a gabim të kryer, edhe pse toni i mësuesit tim qe më i butë e më paqësor se asnjëherë tjetër, urdhri i dhënë m’i kishte futur të dridhurat: kurrë nuk ndodhte që ndonjëri prej nesh të dilte “para klasës” pa u bërë më parë apeli. Me të dalë unë para shokëve të mi (në klasë nuk dëgjohej as miza), mësuesi kishte hapur njëren prej revistave dhe kishte nisur leximin, duke përmendur më parë *emrin e autorit*, domethënë emrin tim:

“Fshati im i dashur, Fshati im i ri, Ngritur mes malesh, O sa bukuri!...”

Unë kisha shtangur. Kështu fillonte njëra prej tri vjershave të mia, të cilat ia pata nisur me postë

para katër-pesë muajsh revistës “PIONIERI”. Një revistë e përdyjavshme për fëmijë, abonimi në të cilën qe i detyruar për të gjithë nxënësit. Vetë i kisha nisur vjershat, pa më thënë kush. Të shkruara në një dyfletëshe nga fletorja e bukurshkrimit. Me shkrimin tim të dorës e që mezi lexohej. (“Ke shkrim pulash”, më qortonte shpesh mësuesi i gjuhës dhe i leximit.) Në njërin prej numrave të revistës - çdo numër e lexoja nga fillimi deri në fund: germë për germë - më kishte zënë syri një njoftim, që bënte fjalë për një “konkurs letrar me rastin 25-vjetorit të çlirimit të Atdheut” dhe *fill* kisha vendosur të merrja pjesë. Pa i treguar askujt.

As tim ati.

As shokëve.

As mësuesit të gjuhës e të leximit letrar.

Që atë ditë isha ulur dhe i kisha shkruar

vjershat. Për një pasdreke të tria. *Fill* të nesërmen i kisha postuar. Bashkë me Ilin, shokun tim më të ngushtë. Edhe pse nuk i kisha treguar se çfarë kishte brenda zarfit. Në njëren anë kisha shkruar adresën e revistës, në tjetrën atë të shkollës sime... Mandej disa ditë shprese, pritjeje e ankthi. Derisa kishte ardhur numri i radhës. I ndezur flakë e me duart që më dridheshin, e kisha shfletuar me të shpejtë revistën. Aty në klasë, nën bankë. Dy-tri herë. Lloj-lloj emrash e vjershash, por askund emri im. Askund *vjershat e mia*. Prapë dy javë pritje. Edhe pse me më pak shpresë e ankth. Numri i radhës. Prapë shfletimi i shpejtë aty nën bankë. Me duart që më dridheshin më pak se herën e parë. Lloj-lloj emrash e vjershash, por prapë askund emri im dhe vjershat e mia. Kështu për disa numra me radhë. Gjithnjë dhe me më pak shpresë e padurim. Derisa *një ditë* i kisha harruar vjershat e mia. Ose ashtu kujtoja unë. Sepse, sapo më binte në dorë numri i ri i revistës, i kaloja fletët me vrap për t’u ndalur te “faqet e konkursit”...

Kurse tani mësuesi lexon me zërin e tij të trashë e të ngjirur:

“Gjyshi im flokëbardhë,

Vjen e më tregon një përrallë. Një përrall’ me partizanë,

Që luftojnë porsi luanë...”

Unë jam skuqur e ndezur flakë. Edhe pse *strofa origjinale*, domethënë ajo që ia kisha dërguar revistës, kishte qenë pak më ndryshe: “*Gjyshi im flokëbardhë / vjen e më tregon një përrallë*

/ Një përrallë të bukur shumë / që më vë natën në gjumë”. Zemra sa nuk më del vendit. Nuk di ku t’i çoj duart. As shikimin. Shokët e klasës m’i kanë ngulur sytë të gjithë, të habitur e disi të çmeritur, thua se më shohin për herë të parë. Sidomos Ili, shoku i bankës.

“Gjaku juaj u derdh lumë, Dhatë jetën për lirinë.

Rritemi çdo dit’ të lumtur, Se gëzojmë Shqipërinë!”

lexon mësuesi strofën e fundit dhe menjëherë më afrohet pranë, ma vë njëren dorë mbi kokë e nis m’i trazon flokët. Sakaq, shokët e klasës zënë e duartrokasin. Sa u hanë duart! Kështu për disa çaste. Mua më mbushen sytë me lot. Pa e kuptuar tamam se pse. Mësuesi bën me dorë për qetësi dhe thotë fjalët e pabesueshme: “Për ma shumë, shoku juej asht’ shpall’ njeni prej tre fituesve të vendit t’par’ në konkursin e 25-vjetorit të çlirimit të Atdheut...”. Shokët e klasës nuk mbahen më: godasin dyshemenë me këmbë dhe me grushte syprinat e bankave. Mësuesi nuk u thotë asgjë, vetëm qesh. Kurse unë nuk di se ç’të bëj. Çfarë të them?

Si të sillem? Vetja më duket si në ëndërr. I marr leje mësuesit dhe nisem për te banka ime. Mezi i hedh hapat deri aty.

Thua se po eci përsipër mjegullave.

“Tradhtar!”, më thotë Ili, sapo ulem. Nuk i kthej përgjigje. Jo se nuk e meriton. Por nuk di çfarë t’i them. Ndërkohë, mësuesi, gjithnjë me atë buzëqeshjen e mezi-dallueshme e si të ngatërruar mes mustaqeve të tija të zverdhura, ua shpërndan revistat të gjithëve, bankë për bankë. Dhe porosit:

“Orën tjetër keni me i than’ përmendsh të tria vjershat e Ridit”. “Tradhtar!”, më shan Ili prapë, sapo dalim jashtë shkollës

dhe të vetëm nisemi për në shtëpi. Unë pres se mos vazhdon me “idiot”, siç më thotë shpeshherë, por shoku im kësaj radhe mjaftohet vetëm me sharjen e parë.



“Taman tradhtar je! As mu nuk më ke diftu se je shkrimtar?”

A nuk më ke shokun ma të ngusht’?”

Nuk i kthej asnjë përgjigje. Sepse *prapë* nuk di çfarë t’i them. Ndoshta “shoku im ma i ngushtë” ka të drejtë: atij duhej t’ia kisha thënë që më herët se *jam shkrimtar*. Rugën deri te shtëpitë tona (përballë njëra-tjetrës i kemi) e bëjmë në heshtje. Si kurrë më parë. Edhe kur ndahemi, asnjë fjalë nuk i themi njëri-tjetrit. Por sa hyj në oborrin e shtëpisë sime, e harroj Ilin me gjithë sharjet e tija. Futem me vrap brenda në shpi dhe ashtu i veshur nxjerr nga çanta e shkollës revistën, të cilën e shfletoj me të shpejtë, derisa gjej vjershat e mia. I lexoj me zë të lartë të tria. Disa herë me radhë. Mandej edhe me sy mbyllur. Përmendsh. As që kujtohem për drekën. As për shportën e fiqve, që duhet ta vjel sa pa u kthyer prindërit nga puna. As për lulet në oborr, që duhet t’i ujis... Veçse hap e mbyll pa pushim revistën dhe lexoj me zë të lartë vjershat e mia. Kur papritur, krejt papritur, më vjen *dëshira* të shkruaj *vjersha të tjera*, të ndryshme nga tri të parat. Njëren për babën. Tjetren për shokun tim, Ilin. Kurse një të tretë... Gris me të shpejtë një dyfletëshe nga fletorja e bukurshkrimi dhe ulem të shkruaj. Harrohem për shumë kohë ashtu. Derisa dëgjoj ndoca kollitje të thata në oborr: është im’ atë! Marr revistën në dorë dhe turrem me vrap drejt tij:

“A e gjen se ça asht? Revista... revista “Pionieri” asht... më kan’ botu tri vjersha... me emnin tem... edhe çmim të par’ më kan’ dhan’...”.

Ashtu i ndezur flakë e me duart që më dridhen nga padurimi, rrekem ta shfletoj revistën e t’i gjej sa më shpejt vjershat e mia. Sapo ndesh në to (faqja 13), ia vë tim’ ati para fytyrës.

“A i shef? Tri vjersha me emnin tem! I pari jam... i pari në krejt Republikën...”

Im’ atë, mbushur gjithandej me fije zdrukthi (marangoz punon), sheh për pak çaste revistën, mandej mua. Me dyshim e mosbesim.

“Vet’ i ke ba?”

“Vet’ babë! Askush nuk më ka ndihmu. As

msusi...”

Im’ atë më sheh prapë me dyshim e mosbesim dhe kur pres që, të paktën, të gëzohet e të lumturohet po aq sa unë, më bën pyetjen e përditshme:

“E ke vjel’ shportën e fiqve?”

“Shportën e fiqve? Jo, babë... Tash po e vjel...”.

Një si lëmsh më mblidhet papritur në fyt dhe gati ma zë frymën. Kurse sytë më njomen prej lotëve. Ul kokën, e mbështjell revistën tub dhe heq këmbët zvarrë drejt haurit të vjetër. Marr shportën e fiqve dhe dal në bahçen mbrapa shtëpisë. Aty i lë lotët të më rrjedhin lirshëm. Edhe kur jam majë fikut, lotët më rrjedhin pa pushim. Si kurrë më parë. Dhe teksa i këpus fiqtë pjekur e papjekur, si të m’i zërë dora, rrekem disi ta justifikoj sjelljen e babait. Por nuk di, nuk mundem. Im’ atë është gëzuar e lumturuar edhe më shumë se unë, kur kam mësuar notin. Po kështu, kur kam mësuar biçikletën. Apo kur kam rregulluar vetë gardhin në fund të bahçes. Kurse tani... E mbush shportën dhe ulem poshtë. Lotët më janë mbaruar. Kokulur futem brenda në shtëpi. Nuk më bëhet ta shoh në sy tim’ atë. Ndërkohë, edhe ime ëmë është kthyer nga puna dhe, me sa duket, e ka marrë vesh lajmin, sepse më uron:

“Të keqen nana!”.

Vetëm kaq. Edhe puthjen e zakonshme, të cilën ma jep sa herë që kthehet nga puna. Asgjë më tepër:

As urime.

As përgëzime.

As lekë.

Kur i meritoj të gjitha. Sepse jam “i pari i Republikës”. Sytë më njomen prapë dhe pa thënë asnjë fjalë nisem drejt dhomës së gjumit. Edhe pse e urrej *për vdekje* gjumin e zhegut, shtrihem vetë në dyshek, pa më urdhëruar babai, siç bën në të gjitha ditët. Sapo vë kokën në jastëk, ai njomet prej lotëve. Ashtu mes lotëve, prapë rrekem t’i justifikoj *sadopak* prindërit e mi, por prapë nuk ia dal.

Derisa më rren gjumi.

Kurse me shokët e mi të rrugicës e të klasës gjithçka do të ishte ndryshe. Që atë ditë. Sapo

mblidhemi në muzg te sheshi para Xhamisë së Vjetër. Se si më shohin. Edhe me admirim. Edhe me pak drojë. Si pas një muri të padukshëm.

Thua se kurrë nuk kanë parë shkrimtar me sy!

Mandej guxojnë dhe më afrohen ngjitur. Në fillim Leta, motra e Iilit. Më sheh butë dhe ma zgjat rriskën e saj të bukës “për një kashat”. Më pas, edhe të tjerët. Të gjithë me rrishtat e tyre të bukës. Drejt gojës sime. Derisa më zë dhimbja e barkut. Edhe kur ndahemi në skuadra (për futboll a lojë luftash), unë jam “i zgjedhuri i parë”. Kur deri dje kam qenë ndër të fundit.

Kështu për tri ditë me radhë. Gjatë atyre tri ditëve, Ili nuk do ta përdorte me mua as edhe një herë sharjen “idiot”, kur më parë nuk kalonte minuta pa ma thënë faqe të gjithëve. Ndodhte që unë ia *bëja borxh* ndonjëherë dhe ai ishte gati të shfrynte, por nga goja, në rastin më të keq, nxirrte vetëm gerrat e para “id”, kurse të tjerat, edhe pse me mundim, i kapërdinte.

Por vetëm tri ditë kështu. Se mandej gjithçka do të ishte si më parë.

Edhe pse unë do të botoja vjersha të tjera te “PIONIERI”.

* * *

Më ndodh që dhe tani, pas më shumë se njëzet vjet përvojë shkrimesh e botimesh, të rri në pritje e ankth sa herë që nis diçka për botim.

Sidomos në dy javët e para.

Edhe pse tashmë, falë dhe njëfarë emri që gëzoj, e kam thuajse të sigurt botimin.

Siç është më se normale që në të gjitha këto raste, pritjesh e botimesh, të më bien ndër mend tri vjershat e para dhe gjithçka tjetër që ndodhi pas botimit të tyre.

2010



KËPUCËT

tregim nga

Hysen Kobellari



1

Atje, në fund të dhomës time, si përfund botës së tejçartur të kotësisë, prehen të heshtura, gojëhapur, besnike, të frikëshme si e nesërmja, si e vërteta që fsheh sekrete, këpucët e mia.

Çfarë doni të thoni e dot nuk flisni, buzëplasura, memecet e mia të dashura ?!

Trak-trak ! Trak e trak ... Jehon pafund e në përjetësi e shkuara juaj e lavdishme. Dhe e ardhmja.

Trokun tuaj baritës fort e dua, ajo është pjesa më e mirë, më e dhembshur e jetës sime; ju kam thënë, kudo shkoni më merrni me vete, duromëni edhe mua të mjerin... Besniket, të heshturat, martiret e durimit të vërtetë të njeriut !

Të zgjidhura, - rrini rehatisht ndjallagjumëse, si zhukatja e blerës. Të lidhura, - ikni me nxitim, me ngut, me mua, me ne, drejt jetës që zhurmon e s’kuptohet qartë se çfarë thotë, që është si pallmë bualli ... Ndryshe nga qentë.

Aty, pranë derës rritni vigjilencën, megjithëse në pushim e në prehje, ruajeni, duajeni, mbrojeni këmbën që iu braktisi përkohësisht, kujdesuni për njeriun! E kini amanet këtë.

Armikun që vjen, kthejani drejtimin, se pa njeriun rrezikzi që doni edhe ju nuk kini kuptim.

Me erën që lëshon goja juaj e hapur, si vesh mënxyre, kumtojani armikut se ku i ka rrënjët këmba, e cila pati lëvizur, luftuar dhe ecur mizorisht brenda jush ...

2

Këpuca ime, o shpellë e spërndritur, vesh i pangopur, sy i uritur ! ...

Me foshnjën e stërmadhe, Turmë, bisedoj dhe dot s’e zgjidh se ç’janë këpucët për njeriun. Por me veten time ujdinë e arrij: jeta për njeriun është këpucë për shpirtin e tij ...

I mençuri, budallai, vrasin mendjen, tëmthat e kokës birojnë me gisht, përse vetëm këpucët, si enët e lashta magjike mbushen e zbrazen vazhdimisht; këpucët, të dashurat e padashura, përjetësisht, shtysë dhe pengesë njëkohësisht...

Të mbash këpucë do të thotë të kesh pushtet mbi veten, të përmbahesh atëherë kur duhet dhe atje ku duhet ...

Dhuro një palë këpucë ! Unë për vete kam dhuruar. Kur njeriu dhuron diçka, duket sikur e largon të keqen nga vetje, duke e degdisur në drejtim të paditur. Teksa dhuron këpucët, ke dhuruar një ftesë për ecje, një graheje për të vrapuar ...

Dhuro, qofsh i bekuar !

3

Më magjeps monologu i këpucëve të lodhura, monodrama e tyre e pakuptueshme plotësisht. Mos u tall, or mik; kurrë nuk lodhen këpucët së luajturi mëngjesthi teatrin e tyre të pambarim e absurd. Ato ankohen vazhdimisht, të heshtura, megjithëse rrinë gojëhapur pa nxjerë zë. Lum kush i kuptoi !

Le të derdhet shafraan lumi i vrerit të cmirëzinjve nën këpucë. Brenda tyre ka paqe. Jo për sy e faqe ...

Dielli mbi këpucë si xhufka farfuritëse e dramës së pashkruar. Hëna mbi këpucë si fiongo kolopuçi që edhe qan, edhe qesh; nën këpucë – fytyra e misterit, të fshehtat e mëdha dhe interesante që na

tërheqin pas...

Zjarri mbi këpucë, fytyrë pabesie. Pështyma mbi këpucë, ruajnazot, mosmirënjohja e vrerët e qoftëlargut ...

Ah, jetë e mbjellë dhe e korrur ! Do t'i mbledh brenda jush këmbët e mia të trembura, për t'i shndërruar në përrua lotësh të shpirtit të lodhur. Jeta shpesh këtë të bën: t'i vë këmbët në një këpucë !

Kur s'të ecën, s'të ecën dhe ti zemërohesh e dot nuk e frenon ngutjen; godet me këpucë ç'të del përpara, gurë e drurë; shqelmon sheligjet shfrenueshëm, shan e mallkon, zemërohesh me njerëzit, me Zotin ...

- Mos u ngut ! Mos u zemëro ! ... - të këshillon këpuca pasi ka hapur gojën e është shqyer për hatër të rebelimit tënd pa fre.

Dhe ti i vë gishtin kokës, qetësohesh, e merr shtruar, pendohesh dhe kërkon rrugë të tjera për të qënë fatbardhë e suksesiv...

4

Këpucët e mia të dashura, a do të kem mundësi t'iu njoh mirë ndonjëherë ?! Sa nis t'iu njoh ndopak, ju shqyeni veten dhe më duhet t'iu ndërroj me të tjera. Për shkak edhe të zemërimit tim dhe faktit që më duhet të kaloj udhë e pa udhë. Duke më ngrënë kësisoj paratë, ato kursimet e mia të mjera.

Më vratë keq ditën e parë që iu vështa ! Si plakun proteza me dhëmbët e rinj që i duhen të përtypë kohën që i ka mbetur. Djersë dhe gjak shtërëzimesh mëkatore ...

Këpucët e mia të dashura kurrë me mua nuk tallen: një zog i vetëm vdes; dy së bashku – ringjallen ...

Këpucët e mia të heshtura, si nuse me tel; njëra qenka Faust, tjetra – Mefistofel ...

Këpucët e mia magjike, ku jeta më mbërthen me ganxha; njëra qenka Don Kishot, tjetra – Sanço Pança ...

Këpucët e mia besnike, ushtare të dritës; njëra e së resë, tjetra – e traditës. Të dyja iu kam dritë të jetës pa travaj, këngë kukuvajkash në maj ...

5

Një flad i lehtë kur fryn e kapelën tej ta flak, ndërsa këpucët, eh !, këpucët ... I ke më të sigurta se ç'ke sipër kokës. Nuk i ndahen Anteut...

- Ngadalë ec, or mik ! – të thonë.

Ç'besnike janë, të uruarat; kurrë s'mërziten, s'bërtasin kot më kot ... Po gojën e hapin. Si peshku jashtë ujit.

Eh, ato, atje, të boshta- pa këmbët. Jetime tek rrinë, tek dera – zvogëlohen përposh, si zgavra sysh- bosh !...

Bëjeni njeriun të ecë, graheni për udhë ! Zogj flamurtarë të lëvizjes... Njerëzoheni botën, miket e mia prej lëkure !

Bëjini zap këmbët e të ligut, vriteni paq në thembër, si Akilin shigjeta ! Sosini ata si soj. Njeriun e mirë nguteni, të ecë më shpejt, graheni për udhë ! ... Trak e truk ! Në punë. Tak e fak ! ...

Vras shpesh mendjen se pse dreri nuk ka këpucë, që të kënaqet kur i zbath e i lë prapa derës. Trak e truk bën këmba e tij nëpër pyll ! Me këpucët e gjalla që bashkëlindin e bashkëvdesin me të. Këpucët e tij quhen thundra. Po. E ka magjinë me vete kjo fjalë. Thur ëndrra. Prandaj ajo murga gjyshe më tha të pi ujë në një gjurmë dreri e të bëhem njeri me fat; fatmadh, fatli, fatbardhë, domethënë ...

Se pse m'u kujtua Thundra e hekurt tani ...

Hirushja, ajo vajza jetime nuk pati këpucë; ecte zbathur, në kërkim të fatit. Papritur ajo i gjeti ato në ëndërritje; këpucët e fatit ishin. Kur t'i gjeni ato,

mos i lëshoni ! ... Këpucë të tilla janë fat i kërkuar, një lloj engjëlli fatndjellës ...

Njeriu, ndërsa e ndjen se e ka braktisur fati, mbase njërën këpucë duhet ta humbasë qëllimisht. Detyrohet ta kërkojë të humburën. Njërën. Po kurrësesi të dyja. Dhe kur të zësh miq, shiko që ata të jenë me këpucë, që pas tyre të paktën të mbetesh me opinga, se po shkove me ata që mbajnë opinga, kur të ikësh prej tyre mund të mbetesh zbathur fare ...

Kush e mendon se fati fshihet në ato këpucë, ose që fatin e gjen vetë këpuca ?! E gjen kush e gjen ... Fatin e gjen lëvizja, ecja pa u lodhur, kërkimi me durim e shpresë. Këpucët janë vetëm shkak. Këpuca është si trupi. Këmba është si shpirti. Jetë të suksesshme e të lumtur të takon të bësh ti, o njeri ! Magjia e suksesit vjen nga veprimi, vrapimi, ecja ...

Me ose pa këpucë.

Kujdes me këpucët ! Tani, në kohët moderne njerëzit këpucët nuk i heqin nga këmba edhe kur shkojnë nëpër dasma, nëpër morte, nëpër vizita tek njëri- tjetri; madje edhe në dhomat intime ku mishi i butë njerëzor mëkaton pa asnjë pendesë; as kur kryejnë nëpër zyra akte të mëdha korruptive për fitime marramendëse, këpucët nuk i ndajnë



prej këmbë. Kësisoj ato dinë shumë gjëra, mësojnë shumë sekrete shtetërore e njerëzore ...

Dikur, nga mosdurimi ose pafajësia ato mund të bëhen pjesë e shërbimit informative të shejtanit.

Të fuqishmit me këpucë të rënda s'venë re ku shkelin e kë shkelin, kë lëndojnë. Ju, këpucë fisnike, kini mëshirë, se të drejtë nuk kini si të jepni, se ju jeni veç këpucë ...

6

Shpirti, e thashë, miq të dashur, edhe shpirti ka këpucë; një këpucë ... Trupin.

Kjo do të thotë se atë e gjen Princi i Kaltër, që quhet Zot dhe që e ka dërguar vetë për ta gjetur, pastaj për të kërkuar të ngjashmen e për të shënjestruar njeriun e vërtetë, të cilit i buzëqesh fati i paracaktuar. Kështu na gënjen mendja.

Pastaj, desha të them që këpucët mos i shikoni thjesht si të tilla, këpucë dhe aq ! Thellohuni kur të mendoni për to; mendohuni mirë, meditoni, përmblihduni paq kur t'i vishni. Nga vete, nga

shkon, buka është me racion ...

Thashë se trupi është këpucë e shpirtit; dikush mund të mendojë se është e kundërta. Ndoshta mund të kemi të drejtë të dy, kush e di plotësisht të vërtetën ?! ... Ja, do të thotë ndonjë gërrnjar, po na çudit edhe ky, duke i vënë shpirtit këpucë ! Epo, besomëni, more njerëz, përse profetët i besoni, a nuk jam edhe unë njeri si ata ?! A nuk kam të drejtë edhe unë të frymëzohem, si ata ?! Se çështje frymëzimi është edhe profecia ... Edhe ju, ama, kini të drejtë të frymëzoheni për të kundërtën, ose të mos frymëzoheni fare, ç'gjale kam unë ?!...

Por këpucët s'kini për t'i harruar. Këpucët janë një lloj atdheu ...

Mos kujtuat se këpucët janë Leva e Arkimedit ?! Leva janë këmbët, këpucët janë këllëfi i tyre. Ato kanë çorapet si ndërmjetëse. Si dorashkat për gishtat e dorës. Gishtat janë si pesë kontinentet e tokës; ndërsa çorapja i bashkon, dorashka i ndan ato.

Po për çorapet do të vijë radha të flas një herë tjetër...

Ja, si shfaqet fenomeni këpucë në trajta të ndryshme në këtë botë !...

Në të vërtetë, po ju them: Mos u bëni ziliqarë për këpucët e mia; mua shamëni, që i lodh e i mbaj gjatë, deri sa të çelin gojë!

Këpucët e mia të dashura ! Dikush m'i ka zili. Ah, sa frikë kam nga ziliqarët! Megjithëse thonë që është më mirë të kesh ca ziliqarë, se sa një thes florinjsh mbi trarë ...

Epo, mos u bëni ziliqarë as për këmbët e mia; për këpucët bëhuni! Këto që kam veshur sot i kam nga Nju Jorku. Këpucëve të mija të dashura ua marrshi të ligat, nëse kanë të liga !

Përfytyroni një botë pa këpucë; ç'botë koti ...

- Sa botë e mjerë ! - thonë disa.

- Kulmi i lirisë, fundi i rrobërisë ! – bërtasin ca të tjerë. Dhe ec e gjejini këpucë sipas masës, mendimeve e ndjenjave të njerëzve, ju lutem shumë !...

Këpuca se pse më kujton gruan. Gruan, në ditët e saj më të mira. Këpuca se pse më ndjell dëshira të marra, të ëmbla, marrosëse, gudulisëse, të vetvetishme, si gruaja kur e kam pranë. Këpucët mos i bëj me baltë, po gruan ushqeje me mjaltë ! ... Majltë jep, mjaltë do të marrësh.

Ah, sikur të mund të ngrija një Kullë Babiloni me këpucë ! ...

7

Nëna Terezën, shënjtoren më të re, e kam parë nëpër rrugët e kryeqytetit tim tek ecte me Jezu Krishtin në sy. Ajo shkelte zbathur nëpër dherat e ngrohtë të atdheut tonë të bekuar. Shënjtorja edhe këpucët nuk donte t'i lodhte. I putha duart, por nuk arrita ta pyes nëse këpucët janë bekim apo mallkim për njeriun. Dhe nëse i donte apo i urrente këpucët. Do t'a pyes kur të takohemi herën tjetër, tek të bëhemi bashkë me të shumtit. Se m'u duk ca e lodhur atë ditë me qiellin, me dheun dhe me njerëzit brenda tyre ...

Shpesh vras mendjen se si guxuan të vishnin këpucë të 12 apostujt, pasi profeti ua lau këmbët, duke iu shërbyer me paravoli, teksa theksoi zgjuarsisht se po të jenë të pastra këmbët, është i pastër tërë trupi !

Po këpucët ?!...

Mos harroni që këpucët njeriu i merr me vete edhe në varr. Të reja fare.

Besniket e përjetshme dhe të përtejjetshme të njeriut !

Besoj se edhe kur të ringjallemi do të vijmë me këpucët veshur ...

Atëhere fillon loja përsënjëzi.

ETYDE DHE VIZATIME PSIKOLOGJIKE — 3

FYTYRA E DYTË
E VIOLETA MANUSHIT

Nga Xhevair Lleshi, shkrimtar & psikolog

Në fillimet e formimit tonë artistik na kanë mësuar të përdorim një model, të cilin jemi munduar shumë për ta imituar, sa të qe e mundur më besnikërisht. Në këtë përpjekje për imitim ne kemi vënë në përdorim të gjitha aftësitë tona. Por, kur kjo përpjekje për imitim filloi të dobësohej dhe arti filloi të bëhej, sa i takon pamjes, gjithmonë e më pak kompetencë e vetëdijes dhe gjithmonë e më shumë aftësitë tona të bëheshin automatike, dora-dorës që automatizmi shtohet dhe fillojnë të ngjiten në skenë shkathtësitë, shprehitë dhe zakonet, mjeshtëria jonë artistike ndryshonte gjithmonë e më shumë nga modeli, aq sa, më në fund, secili prej nesh, edhe pse fillimin e ka nga e njëjta pikënisjeje (modeli), vjen një ditë dhe ecën në tragë të ndryshme nga tjetri.

Fakti që secili ka një mënyrë vetjake pune dhe krijimi, e cila me kalimin e kohës merr, gjithmonë e më shumë formën e vet, shpjegohet nga psikologjia e artit me *forcën shformuese*, jo sipas modelit. Kjo forcë është vetë *nënvetëdija* që në formën e energjisë (me *energji* kuptojmë *rrjedhë force*) ngërthehet me automatizmat dhe projekton në pamjen e artit *tendencat dhe prirjet e psikikës*, prandaj dhe arti bëhet më vonë *një provë psikodiagnostikuese e personalitetit*, shumë më tepër analitike dhe e pasur me të dhëna se sa provat e tjera *psikodiagnostikuese* të përdorura gjatë rrugës sonë artistike.

Forca shformuese vërehet që herët, që me vijëzat e para. Dhe kjo ndodh sepse ai habitet nga përpjekja për imitim. Kemi parë se diçka e ngjashme i ndodh atij që, pasi e ka mësuar artin nga automatizmat, përpiket të fshehtë veprimin e tij, si për shembull në *letrat e para shpesh të panjohura*. Edhe në këtë rast *forca shformuese* i lë gjurmët e saj dhe është pikërisht ajo që, duke bërë që argumenti të ndryshojë në mënyrë karakteristike nga një individ tek tjetri, zbulon prej saj personalitetin.

Ai që në fjalën e tij të zakonshme ripërsërit shumë besnikërisht modelin, zbulon me këtë gjë se jo vetëm ka një forcë shformuese të dobët, por edhe personalitet pak të fuqishëm, ashtu siç është edhe pasiv në mjedisin e jashtëm dhe vetëkuptohet edhe në art.

Ndërsa ai që ka një fjalë dhe formim shumë larg modelit, tregon se ka, paralelisht me një forcë të dukshme shformuese, edhe një personalitet tërë spikamë, i cili i kundërvihet me shumë fuqi veprimit të botës së jashtme, ndaj të cilit tregohet tejet aktiv.

Forca shformuese aq më shumë del në pah sa më i vogël është kontrolli i vetëdijes mbi fjalët dhe argumentet dhe prandaj aq më automatikisht kjo pamje formohet...

Sikur të bëja një ekspozitë personale me fotot e roleve të mia, nuk do të qe keq. Pa ndonjë skemë, edhe pse ndoshta të çuditshme. I kam tmerr skemat. E di që do të vinin shumë miq e mikesha, aktorët, regjisorët dhe... Po edhe shoqet e mia të vjetra tipografe. Janë gra energjike dhe gati të paepura ato. Kam ikur që njëzet vjeç nga puna në tipografi dhe, e veshur ashtu thjesht, po zyrtarisht mirë dhe e mbajtur me tërë seriozitetin e duhur. Ku janë tipografet e mia? Si nuk luajta njëherë fytyrën time të asaj vajze të mbyllur e të turpshme që bënte rrugën nga shtëpia në punë me një ngut të papërmbajtur? Më detyrova të rrëfëhem sonte. Kaq thjesht? Duket që je profesionist. I përmbajtur. Mos ke kaluar nën zdrukthin e Sherit? Ah, Sheri Mita! Ç'zë melodioz! I këndshëm. I palodhur. Këto fjalë tingëllojnë si slogane, por sot ama, se ato kohë ne ishim ikona... Apo mbetëm të tilla? S'e di. S'e pashë mirë provën tuaj të *Rrënjë të thella*. Liri Lushi, Sokol Progni, Foto Vogli, një trio e bukur. Ç'punë do të kishin përpara! Mrekulli! Sheri erdhi dhe u ul në karrigen bosh. U mërzi? Ajo qeshi teksa po shihte e trembur Ilir Pipirinë që po largohej me hapa të gjatë dhe me siguri do ta mbante vrapin drejt lumit. Ne rrinin në verandën e ish-turizmit të Beratit. Prisnim të vinte Drita, regjisorja e dramës, ardhur enkas nga Tirana. Dukej se kishte ndodhur diçka e rëndë. Sidoqoftë, Sheri

e njihte mirë Ilirin dhe e dinte që bënte kundërpërgjigjen e thekur të ndonjë batute nga Ardian Cerga, aktori tjetër fin i teatrit. Djem të rinj, sapo mbaruar shkollën. Ah, të isha edhe njëherë në këtë moshë! E ç'do të bëje, Violeta? E ç'do të bëja tjetër veç atyre që kam bërë. *Tartufi, Rrënjë të thella, Mikroborgjezët, Orët e Kremlinit, Gjenerali i ushtrisë së vdekur, Morali i zonjës Dulksa,*



Arturo Ui, Lumi i vdekur, Karnavalet e Korçës, Zonja nga qyteti, 14 vjeç dhëndër, Epoka para gjyqit, Borgjezi fisnik, Fytyra e dytë, Pallati 176, Kati i gjashtë... Role pa fund. Edhe në film. Çfarë rolesh! Drithëroj nga emocionet. Po i kam harruar të gjitha përveç «Fytyra e dytë» dhe «Zonja nga qyteti», Ollga. Ama secili rol është një histori e gjatë, më vete. Tek *Fytyra e dytë* duhet të shihja kurdoherë dritë, qoftë kjo edhe e mekur. U bë edhe inja e *dytë*, si në ato legjendat e bukura që mezi tregohen. Përgjigjja vinte si erë dhe tani por edhe ikte si bijë e erës, si stuhi. Duhej të isha e qeshur, të dija të ledhatoja, t'u jepja të gjithëve buzëqeshje marramendëse. Çudira të thekshme, po edhe të famshme... Në mes të interpretimit kisha mbetur e kapur në çarkun e trishtimit, ardhur befas. Harrova. Papritur harrova. I dija gjithë truket për të dalë nga situata, por edhe ato m'u shuan. Isha gati të qaja, të ulërija. Ja edhe mrekullia ndodhi. Harrova radhën, sikur m'u shua gjithçka. Duhej të isha zverdhur në fytyrë. Dhe në skenë isha vetëm, pesëmbëdhjetë sekonda të paharruara. Si ishte e mundur? Një mal me role... Por një zë buroi nga nënskena: fytyra e dytë, afrohu!

Drita e famshme ndriçoi përbrenda, zbrita shkallët dhe më njëherë dorë tërhiqja anash fustanin e bukur për të zbuluar këmbët. Ia dola? Bëra vetëm lëvizje për të fituar siguri. Një shenjë, një stigmë e asaj që vjen si me rrëmujë, diçka prej kotësie. «Jeta është e mërzitshme,» thashë, «gri, përsëritje e dëmshme...» Kaq duhej dhe i dhashë trupit fort. Edhe pak e humba ekuilibrin. Edhe ajo më duhej! Bukuria dhe dëlirësia, më hodhën gjak të tepërt në fytyrë, mbeta pa e bërë si duhet Hirushen, sikur papritur do ta gjeja veten në spital gati duke dhënë shpirt. Ja këtë gjendje më dhuroi ndoshta lodhja me «Fytyrën e dytë». Ka humbur me sa duket gjaku i sentencave të vjetra, alternativa e jetës, larmia e pafund e së keqes dhe e së mirës, të dish si të bësh më të mundimshmen. Por drama do të mbaronte me aq? Nuk e di. Veç di që atë çast nuk e harrova kurrë. Tërë jetën. U duk sikur drama *Fytyra e dytë* më dhuroi edhe mua një fytyrë e dytë. Do t'më lehtësonte filmi, reklama, jeta jashtë, parku i madh... Ç'të bëja? Nuk ndodhi kurrë më.

...Do të kishte qenë vërtet e tmerrshme. E shihja të qeshurën e saj dhe habitesha me të. Fytyra e dytë ishte maska. Kurse në rrëfimin e saj Violeta Manushi qëndroi pa lëvizur një çast dhe vuri buzën në gaz. I ngriu në sy diçka tronditëse. U bë shkak fytyra e dytë e teatrit që të mos krijoja familjen time të ngushtë. Më dukej se në marrëdhënie vija maskë dhe nuk isha vetvetja. Të duket si për të vënë duart në kokë? Fundja, të drejtë ke. Por ama jo vetëm loja në një dramë a komedi duan fytyrën e dytë, po edhe në jetë është e njëjta maskë. Ja, këtë që dinë të gjithë kam zbuluar. Njerëzit nuk janë vetvetja. Hyn dhe në shtëpitë tona ku si një dashnore dhe ku si dashnor. Me fëmijët që ikin shpejt dhe kthehen vonë e më vonë. Me vetminë e kobshme. Eh, vetëm kemi ardhur në këtë botë dhe vetëm do të ikim... Jetë e rëndomtë. Batërdia e moralit, si një gërmadhë që na ha shpirtin, budallallëku, singëriteti i shtirë, skandalet, pa ndjerë gjë prej gjëje shpirtërisht, përplot nxitje dhune, përpëlitje si të përshtatemi më mirë. Dhe kjo po ndodh. A ka dashuri? Belbëzim i drithëruar buzësh që digjen. Nuk besoj. Edhe prapë më duhet të besoj. Eh, në fund, sigurisht që del dielli. E qeshura e saj e zakonshme. Ku e kish lënë fytyrën e dytë? E kërkoi dhe e kërkoi atë mbrëmje në tarracën e hotel Turizmit në Berat dhe nuk e gjeti dot. Harroi sërish që e pat vënë mbi të parën prej një kohe të gjatë. Dhe ashtu mbeti, bashkë me të...

Tiranë, më 12 mars 2020

Shumëkush do të ketë dëgjuar a lexuar për klubin 27, radhën e trishtë të artistëve njëzeteshtatë vjeçarë që kanë ndërruar jetë në këtë moshë kaq të re. Ndonëse më të njohurit ndër ta janë emra nga bota e muzikës rok: Brian Jones, Janis Joplin, Jim Morrison, Jimmy Hendrix, etj., - deri te anëtarët më të fundit: Kurt Cobain dhe Amy Winehouse - , kjo listë morbide përmban edhe emra nga piktura, letërsia e të tjera arte.

Në këtë listë gjendet edhe emri i Georg Traklit, jeta e të cilit, përsa i përket përdorimit ekscesiv të drogës nuk u lë asgjë mangut emrave të lartpërmendur; shkaku i vdekjes po ashtu: mbidozë kokaine.

Në vjeshtën e vitit 1914, pas një beteje në kuadrin e Luftës së Parë Botërore në Grodek, në të cilën forcat austriake pësuan shumë humbje, Traklit iu desh - si farmacist ushtrie në rangun e një togeri, pa ndihmën e ndonjë mjeku - të kujdesej për 90 të plagosur rëndë, të cilët ishin strehuar, për mungesë kushtesh të tjera, në një hambar. Meqë nuk kishte as medikamente atypari e as nuk mund t'u ndihnte njëfarësoj, ai ishte i dënuar kështu të mbetej vetëm një vëzhgues pasiv.

"Klithmat nga dhimbjet, - shkruan një biograf, - vdekjet shpesh të lemerishme ia tendosin edhe më gjendjen shpirtërore, që ishte edhe pa këto vetiu e brishtë. Përkundraill dikush qëllon veten në kokë me një pisqollë dhe Traklit i duhet të shohë se si trutë e copëtuar varen nëpër muret e hambarit."



POETI GEORG TRAKL ANËTAR I KLUBIT 27

përzgjedhi e përktheu: Arb Elo

Trakli kishte përshkruar shpesh pamje e atmosfera të tilla dëshpërimi e asgjësimi dhe, - si pakkush nga poetët, - i kishte njohur vetë nga afër përjetime të tilla qysh më parë, mirëpo realiteti, shpërfaqja e tyre faktike në jetë, shemb edhe ndarjen e fundit e të hollë mes vizioneve të tij të kaosit dhe vërtetësisë së këtij të fundit në këtë botë.

I çmeritur ai rend përjashta. Por "Para hambarit tunden nëpër pemë dezertorët e varur. - vijon biografi, - "Kupa mbushet; në mbrëmje poeti ngrihet papritur mendjeçartur në mes të shokëve të armëve dhe rreket t'ia heqë vetes me revolverin e brezit. Ia heqin armën nga dora. Ai vjen përsëri në vete, qetësohet dhe i kthehet shërbimit."

Dy javë më vonë ia del sidoqoftë të ndërrojë jetë me një mbidozë kokaine në rrethana të paqarta,

1.

Vepra e Traklit përbëhet vetëm nga njëqind e ca poezi, tri-katër pjesë për teatër, që pjesërisht kanë humbur, dhe pak letra, në më të shumtën e tyre të padatuara.

Nuk gjendet tek ai asgjë nga ato që e bëjnë interesant një lirik për publikun; as nuk ka patur - si Rilke-ja, për shembull, - ndonjë letërkëmbim me njerëz të shquar apo me influencë dhe as nuk ka rënë në sy për skandale private, - si poeti Dylan Thomas, fjala vjen.

"Ana e jashtme e jetës së tij nuk ngjall interes, ai duket sikur çon rutinën e një jete të mërzitshme të një qytetari çfarëdo", - shkruan i njëjti biograf. Natyrisht që kjo vlen vetëm për përshtypjen që do të kishte atëbotë ndokush që do ta kishte njohur Traklin vetëm për fytyrë. Sepse, në të vërtetë, jeta e poetit nuk është aspak e mërzitshme për shkak të normalitetit, ndonëse ngjan si e tillë së jashtmi: vepra dhe ekzistenca e tij njerëzore u nënshtrohen tërheqjes së autorit dhe prirjes kah marramendja dhe vetëshkatërrimi.

Georg Trakli, lindur më 1887 si fëmija i katërt i një tregtari hekurishtesh nga Salzburg-u - ai kishte tri motra dhe dy vëllezër - përshfaq sidoqoftë të gjitha simptomat, në kuptimin qytetar e shoqëror të fjalës, të një njeriu të pazellshëm, të një bjerrakotasi.

Kur kishte qenë fëmijë, kishte dashur një herë të ndalonte kuajt e lidhur të një karroce në revan, duke u dalë këtyre përpara me krahë të hapur. Diçka të ngjashme do të bënte ca më vonë me një tren: në të dyja rastet e tërhoqën në çastin e fundit të rriturit. Në moshën tetë vjeçare kishte rënë një herë aq në të thella, sa gjatë një shëtitjeje u fut në ecje e sipër në një pellg, pa e vënë re vetë këtë. Vetëm me zor e shtynte veten për në shkollë, që iu desh ta linte pastaj për rezultate të pamjaftueshme. Në dëftesë lexohet: gjuha gjermanisht: "Mjaftueshëm.

Nota: kaluese."

Edhe në zanatin e farmacistit, që do të provonte ca më vonë, sipas të dhënave të shefit të vet, nuk është se shquhej fort për profesionalizëm.

"Trakli dhe unë qemë asokohe dy heretikë të jetës qytetare", - shprehej Oskar Kokoshka për kohën përpara Luftës së Parë Botërore, kur kishte patur miqësi me poetin. Fakt është sidoqoftë që Trakli nuk ishte konsoliduar asnjëherë në zanatin e tij si farmacist ku mbante gradën e magisterit.

Një vend pune në spitalin e garnizonit të Insbrukut e la pa u mbushur gjysma e vitit, ngase e shqetësonte aq shumë komunikimi me njerëzit, sa në një paradite të vetme i ish dashur një herë të ndërronte gjashtë këmisha, aq kishte djersitur nga zori.

Me pesëmbëdhjetë nisi të shkruante poezi, shtatëmbëdhjetë vjeçar pjesë teatrale. Më 1906 - nëntëmbëdhjetë vjeçar tashmë - iu vunë në skenë dy njëaktësja - "Dita e të vdekurve" dhe "Fata Morgana" - në Stadttheater-in e Salzburg-ut, prej të cilëve sot ekzistojnë vetëm afishet e programit. Tekstet i ka asgjësuar - në unanimitet me kritikët e teatrit atëbotë për vlerën e tyre - vetë autori.

Ka fort të ngjarë që prej tij të mos ishte botuar në të gjallë asnjë varg, nëse këto nuk do t'i kishin rënë në dorë një miku, Erhard Buhbekut, që u bë më vonë drejtor i Burgtheater-it të Vjenës. "Me këtë rast", i shkruan Trakli mes të tjerash Buhbekut, "po të nis një poezi të vogël! Me lutjen: (poezia është gati qesharake - por kjo nuk ngre fort peshë) ki mirësinë t'ia dërgosh ndonjë gazete - meqë unë vetë nuk do të bëhem kurrë mbarë për këtë. Pullën po ta fus në zarf." Dhe: "Adresoje gjithçka në adresën tënde - vëri, nëse është e mundur, ndonjë emër tjetër e jo timin! Mbi të gjitha, mbaje këtë për vete e mos e përflit me kënd."

Kishte frikë dhe panik nga kontaktet me gjindjen, që i dukej se kishte për shtysë çmendurinë dhe fiksime. Përgjegjësia më e vogël që i duhej të mbante vetë e bënte të humbte pusullën menjëherë. Kur Ludvig von Ficker-i, botuesi i revistës "Feneri", ku qenë publikuar më të shumtat e poezive të tij, i pati siguruar nga një fond artistësh 20.000 krone dhe ndodhej me të në bankë për të tërhequr shumën, poetin e zuri paniku dhe ia mbathi me vrap përjashta.

"Do të doja të mbështillesha i tëri dhe të ikja i padukshëm tjetërkund", i shkruan ai Buhbekut. "Jo, punët e mia nuk më interesojnë në të vërtetë fare."

Në paraqitje, siç e përshkruajnë miqtë, Trakli nuk të linte përshtypjen e dikujt që ka marrë arratinë nga bota: shpatullgjerë, me duar të fuqishme dhe një fytyrë mjaft të shëmtuar. E përçmonte lumturinë, sikurse edhe poetët që i jepeshin përshkrimeve të natyrës, por jo pijen. Dhe jo vetëm atë.

Për të marrë arratinë nga kjo botë Trakli kishte mjete shumë më të

efektshme se alkooli. Katërmbëdhjetë vjeçar akoma e kishte zakon që cigaret - që i pinte rresht - t'i ngjente në një tretësirë opiumi. Më vonë mbante gjithnjë me vete një shishkë me kloroform, me të cilën topitej shëtitjeve deri në humbje të vetëdijes. Nganjëherë e gjenin jashtë gjysmë të ngrirë nga i ftohti dhe u duhej ta sillnin në shtëpi në një gjendje të tillë.

Farmacist siç ish, kishte edhe mundësinë që t'i përmirësonte këto teknika. Shumë shpejt nisi të marrë doza aq të mëdha opiatesh, sa nuk merrej vesh në do të vinte më në vete kur i binte të fikët.

Këto përjetime do ta kenë bërë lirikun ndoshta t'i dukej dashuria për jetën e bashkëkohësve dhe moskokëçarja e tyre si çmenduri. Akte të vogla të shëmtuara e të përditshme - dhënia shpirt e një qeni, shkelja e ndonjë buburreci - e dëshpëronin fort: me sa duket, ai i projektonte të tilla vrasje në miniaturë në siparin e madh historik të kohës, siç shkruante qysh në vitin 1913:

*"Njerëzim radhitur para grykash zjarri,
Rënie daullesh, balle luftëtarësh të errët,
Hapa mes gjakmjegulle; tringëllon hekur
i zi,
Dëshpërim, natë në tru të trishtë, të
brengët..."*

Nga ata pak njerëz me të cilën poeti mbante marrëdhënie më shumë se sipërfaqësore, një nga edhe më të paktat femra mes tyre - me siguri e vetmja grua që ai ka dashur vërtet - ishte motra e tij më e vogël, Margarete, e cila u vetëvra vetëm tre vjet pas vdekjes së tij. Ka biografë e interpretë që flasin për një marrëdhënie incestuoze mes tyre, megjithatë nuk duket të ketë prova dhe dëshmi të qarta për këtë tezë. Kështu, të paktën, pohohet në një biografi nga më të fundit për Traklin të vitit 2014.

Grete, siç quhej shkurt e motra, përshfaqet në disa pamje në poezinë e Traklit, - si "murgeshë", si "e huaj", edhe si një nga pinjollët e "rodit të errët të mallkuar" - thua jse gjithmonë si personifikim i fajit. Shkruhet shumëkund edhe që poeti paskësh flirtuar një kohë me mendimin e një vetëvrasjeje të përbashkët, për të shlyer kësisoj fajin gjithashtu të përbashkët. Mirëpo këto janë hipoteza të pabazuara në fakte. Sidoqoftë punët nuk erdhën derimë aty, pasi me shpërthimin e Luftës së Parë Botërore Trakli u rekrutua.

Dhe se sa të drejtë kishte patur, kur bënte kujdes e kishte frikë nga kontakti me botën, e tregojnë më së miri rrethanat që shpunë në vdekjen e tij të parakohshme. (Mbase edhe hamendësimet e kritikëve dhe studiuesve të tij për incestin pa prova, do të shtonte përkthyesi i këtyre radhëve, por kjo nuk do të ngrinte më peshë sot e kësaj dite, kur tërë të përfolurit, - poeti, shumica e kritikëve, siç edhe më të shumtët e studiuesve, - nuk gjallojnë më, pak rëndësi ka në u



paskësh ardhur fundi i pashmangshëm për shkaqe natyrore apo njerëzore.)

Trakli çon pra në vitet para luftës një jetë në dukej qytetare, i pëlqen ta kalojë kohën në kafene me kameradët e vet (ku pihet nganjëherë përtej masës), viziton bordelet e Zalcburgut, ndërkohë që për incestin e përfolur në literaturën e dorës së dytë me motrën Grete nuk sillen prova.

2.

Ky talent i hershëm u rrit në të frikshmin "ambient shtëpiak të mirënjohur", për të cilin bëjnë fjalë shumë përshkrime letrare në mbarim të shekullit të vjetër e në fillimin e të riut, atij të njëzetit - mjedise të pafjala dhe të zbrazura nga dashuria. Kjo nuk e pengonte njerëzinë asokohe të pohonte që një martesë me shumë fëmijë qenkësh "e bekuar"; ndërkohë e ëma murosej pothuajse në heshtje në një strehim të mobiluar në mënyrë groteske: ajo mblidhte me një tërbim të vërtetë prej blerëse antikuitete që i donte dhe i ruante më fort se fëmijët.

Si përhitje e zbehtë, e flashkët fanitet ajo - shumë rrallë - në poezitë e të birit. Ndërkohë që ky paskësh qenë në vërtetë nxënësi i lexuar dhe fliste frengjishten, të mësuar prej guvernantes franceze që kujdesej për fëmijët, meqë e ëma ishte dhe ajo e varur nga droga: "ngrënëse opiumi" e quan ai diku.

Rembonë - njërin nga "ndikimet" - e njihte nga përkthimet, po ashtu lexonte Meterlinkun, Georgen, Niçen, Bodlerin, Vërlenin. Ishte po ky, Remboja dhe ideja e tij mbi "ngjyrat e shkronjave" dhe ajo e "halucination des mots", që e kishin prekur më Traklin më shumë. Kryefjala është kjo: halucinacioni. Dihet që Remboja i çonte shpesh netët në ferrin e drogës, ndërkohë që Trakli

kishte eksperimentuar qysh herët me "helmet". Ka mbetur një letër e hershme e tij për mikun Buhbek, ku poeti "i rrëfëhet" që ka gjetur strehë "për fat të keq sërish te kloroformi. Efekti që i frikshëm."

"Gjurmët e pakta jetësore të Traklit", - shkruan biografi i fundit i tij, - "shumohen në një dëshmi me intensitete të ndryshme, që shfaqen edhe atëherë, kur ai është i pavendosur, kur vegjeton i trullësuar ditët apo vuan zhvendosjet e ndërsjellta të nervozitetit me mërzinë. Ai përjeton gjithçka në mënyrë intensive, të ardhurit në majë të hundës dhe neverinë (shpesh për veten), përjeton të bukurën në të shëmtuarën dhe të neveritshmen në të bukurën."

Droga tjetër e poetit është gjuha. Misteri i lirikës së këtij njeriu, i cili nuk kupton unin e vet dhe nuk kupton botën gjithashtu, është i ndryrë me rigorizitet. Bashkëkohësit e tij, shumë prej tyre gjenialë, - emra si Hans Arp, Jakob van Hoddis, Georg Heym, Kurt Schwitters, Gottfried Benn, Albert Ehrenstein, Max Herrmann-Neisse, etj., - ishin moshatarë me të, një vit më pak a më shumë. Nuk është vërtetuar gjithashtu, nëse Else Lasker-Schylleri paskësh qenë e dashura e tij për pak kohë. Ekzistonte pra ndërkohë modernizmi i hershëm.

Në sproven e tij "Gjuha në poezi", me nëntitull: Një udhërrëfim në vendin e poezisë së Georg Traklit, - Martin Heidegger-i shkruan mes të tjerash: "Çdo poet i madh vjershëron prej një vjershe të vetme. Madhështia e tij matet me sa ia del ky të fitojë besimin e kësaj të premtuare të vetme, sa mundet ky ta ruajë të pastër fjalën e dhënë vjershëruese. Vjersha e një poeti mbetet e pathënë. Asnjë nga vjershat e tij, edhe të tëra tok, nuk e thonë dot të tërë atë vjershë të premtuar. Prapëseprapë,

çdo vjershë flet nga tërësia e asaj të premtuare të vetme dhe thotë çdo herë po atë."

Mirëpo ky lirik mori një shteg të vetmuar, kumbimin e asaj çapitjeje e ndryu në vargje të një bukurie të frikshme. Ernst Bloch-u dhe Walter Benjamin-i kanë fiksuar në "Protokollë për përvoja me drogë" se ku duhej të mbaronte ai shteg: "Nis të marrë trajtë një udhë e dëbortë që të shpie përjashta, drejt dehjes, e kjo udhë është vdekja."

Një nga metaforat më të shpeshta në veprën e Traklit janë tingujt e kambanave. Më 25 tetor, 1914, Kurt Volfi merr në telegram nga fronti: „do të më dhuronit gëzim të madh, në do më dërgonit një ekzemplar të librit tim të ri “sebastiani në ëndërr“. dergjem i sëmurë në spitalin e garnizonit të këtushëm në krakov. georg trakl."

Nuk ishte e thënë ta merrte këtë vëllim në duar.

"Grodek" titullohet vjersha e tij e fundit, pas betejës afër Grodekut më 13 tetor 1914.

Në atë spital i sëmuri ishte sjellë më 8 tetor "për të vëzhguar gjëndjen e tij mendore". Një shënim mjekësor konstaton: "nuk është i pirë, por ka marrë shumë kokainë... gjithashtu dëgjon shumë tinguj kambanash... pacienti pohon se rrjedh nga një kardinal dhe se në të ardhmen do të bëhet një zotëri i madh." Së fundmi njëfarë Dr. Haveli ateston më 4 nëntor 1914 "vetëvrasje me kokainë". Vdekja ka ndodhur më 3 nëntor, në ora 21.

Zotëri i madh? Ishte bërë poet i madh. Një nga më të mëdhenjtë. Leximi i tij i fundit ishin poezitë e shkruesit barok të hymneve Johann Christian Günther. Vjersha e këtij "Mendime për shlyerjen e mëkateve" mbyllet me vargun: "Shpesh një vdekje për të qenë është jetëshkrimi më i mirë nga të tërë".



ÇARLS DIKENS VËRTET, VËRTET E URRENTE ADHURUESIN E TIJ HANS KRISTIAN ANDERSENIN

nga Olivia Rutigliano

Carls Dikensi dhe Hans Kristian Anderseni u takuan për herë të parë në një pritje në verën e vitit 1847. Anderseni nuk ishte ende i njohur në Angli (përrallat e tij po përktheheshin nga danishtja për herë të parë), dhe ai ishte yll në ngjitje. Ai iu prezantua Dikensit shumë më të famshëm dhe duke e quajtur “shkrimtarin më të madh të kohës sonë”. Diçka e bukur. Mbase pak e tepërt ta thuash, por gjithsesi e bukur. Patën një bisedë miqësore, dhe më pas, Anderseni u shkroi një letër miqve në Danimarkë, shumë i ngazëllyer që Dikensi kishte përmbyshur pritshmëritë e tij. Edhe Anderseni me sa duket la një përshtypje të

mirë tek Dikensi, sepse disa javë më vonë, i dërgoi një pako me disa nga librat e tij dhe një shënim personal.

Ndoshta ky gjest i dha pak si tepër zemër Andersenit meqenëse i dërgoi rregullisht letra gjatë nëntë viteve të ardhshme. I mërzhitur nga letërkëmbimi, në vitin 1856-të Dikensi, në një letër të mbushur me lajka të çuditshme që shpesh thonë pak ose aspak ngaqë përmban thjesht formula mirësjelljeje, përmend në mënyrë të pasinqertë dhe të guximshme se Andersoni ishte i mirëpritur të qëndronte në familjen e tij, nëse ndodhte që ndonjëherë të ishte këtej. Gjë që absolutisht, nuk e kishte me të vërtetë.

Por në mars të vitit 1857-të, Anderseni i shkroi me ngazëllim Dikensit për t'i treguar se po udhëtonte për në Angli, për vetëm dy javë, dhe kjo sepse e kishte pranuar ofertën e tij. Dhe kështu, në qershor të atij viti, Anderseni mbërriti në Gad's Hill, prona e Dikensit në Higham, gati të bëhej shok dhome me heroin e tij. “Vizita ime është vetëm për ju”, - shkroi ai. “Përherë lini për mua pak vend në zemrën tuaj”. (Nëse Anderseni s'do të dukej kaq shumë i këndshëm, përvoja do të ngjante si film horror. Unë e kam *parë* vetë këtë film horror.)

Edhe pse familja Dikens po e priste, në një farë mënyre, ata kurrë s'e kishim çuar në mend këtë vizitë. Anderseni, i ngathët në marrëdhëniet shoqërore dhe me sa duket një nga të përkëdhelurit letrarë prijës të shekullit XIX, nuk ishte i mirë në përshtatjen me zakonet shoqërore ose mënyrat e të sjellurit zyrtar, duke kërkuar në një mënyrë ose tjetër të ishte në qendër të vëmendjes. Pasi u rehatua, i kërkoi njërit prej djemve të Dikensit ta ndihmonte me rruajtjen e përditshme të mjekrës, duke sqaruar se ky ishte zakon mirëpritjeje për mysafirët meshkuj në Danimarkë. I çuditur, Dikensi i rezervoi një takim të përditshëm tek një rrojtore aty pranë. Një natë, gjatë darkës, kur Dikensi zgjati njërin krah për njërin nga zonjat e pranishme, Andersoni doli me vrull para dhe e kapi vetë për krah për të shkuar kapur për krah me të në dhomën e ngrënies. Për të mos përmendur faktin se ndenji tre javë, më gjatë nga sa kishte pohuar fillimisht.

Tani, Dikensi s'ia kalonte mirë kurdo që kishte mysafir shtëpie (e jo më një të tillë kaq harraq). “Vogëlushja Dorrit” nuk po pritej edhe aq mirë nga kritika, dhe ai po përpiqej ta linte bashkëshorten për një grua që kishte gjysmën e moshës së vet. Pëveç kësaj, luante në dramën e mikut të tij Uilki Kollins, “Të kallkanosurit”. Pra, nuk kishte kohë për të sepse ishte angazhuar në shumë gjëra të rëndësishme.

Dhe sikur të mos mjaftonin këto, Anderseni ishte edhe tip i vështirë për ta pasur në shoqërinë tënde. Në premierën e dramës ku Dikensi luante rolin kryesor dhe në audiencë ishte mbretëresha Viktoria, Anderseni shpërtheu në lot me zë të lartë. Pas kësaj, me sa duket ndenji i zyrtë sepse prania e tij në këtë ngjarje nuk u vu re më shumë. Pastaj kur mësoi se për një nga veprat e tij ishte shkruar një recensë negative, doli me vrap i shqetësuar në lëndinën e familjes Dikens dhe qau plot pasion. Pavarësisht nga ky spektakël, Kate, vajza e Dikensit, tha se ishte “i mërzhitshëm





Letrat e Çarls Dikensit (në foto) zbuluan pakënaqësinë për bujtësin e tij, autorin danez Hans Kristian Andersen. Fotografia: Rischgitz/Getty Images.

për vdekje”. Është hamendësuar nga disa se Dikensi mund ta ketë mbështetur tek mysafiri i tij personazhin e pikëlluar dhe servil të Uriah Heap-it në romanin “David Koperfeld”. Hamendësohet gjithashtu se Anderseni e mbështeti personazhin e Rosakut Shëmtaraq tek vetja.

Dikensi u ankua shumë herë për mysafirin në letrat që shkroi, ngaqë s’kishte gjë ku të mos përfshihej për shkak të kureshtjes së tij të çuditshme. I rritur në fshat, Anderseni dyshonte se mund të vidhej nga ndonjë hajdut xhepush në qytet, dhe Dikensi shkroi në mënyrë sarkastike se një herë, një shofer taksie ndoqi nëpër Londër një rrugë ndryshe nga ajo e zakonshmja, dhe kjo e bëri Andersenin të arrij në përfundimin se shumë shpejt do të grabitej dhe vritej, kështu që i futi të gjitha sendet në çizmet që mbante veshur, orën, paratë, orarin e trenit, “një bllok shënimesh, një palë gërsërë, një “brisk xhepi” dhe disa sende të tjera, siç duket, dy libra të vegjël. Këmbët iu bënë plagë, s’mund të mos përmendte me këtë rast Dikensi.

Dikensi po kështu dyshonte për përkushtimin e Andersenit ndaj të shkruarit, duke u ankua se: “ai veç bënte zbukurime me letra të prera duke krijuar gjithçfarë modelesh, dhe sajonte buqeta të vogla me lule të çuditshme të mbledhura në pyll”. E zbukuroi kapelen e Uilki Kollinsit me një varg luledesh, e cila e bëri pa e kuptuar fare objekt talljeje në qytet.

Por fyerja më e rëndë ishte për aftësitë e shkrimit dhe të folurit të Andersenit. Dikensi i tha një shoku kur e ftoi në shtëpi se: “Hans Kristian Andersen mund të jetë me ne, por s’ke për ta vënë re praninë e tij, sepse s’flet asnjë gjuhë përveç danishtes, dhe ka dyshime se as danishten s’e di”. Ai u ankua edhe se: “Nuk shqiptonte dot në italisht titullin e librit të vet “Improvisatore” ndërsa përkthyesi i tij duket se ka kuptuar që Anderseni s’e flet as gjuhën daneze”. Sa për

frëngjishten “e flet si ai i gjeturi që jetonte që i vogël me kafshët, kurse anglishten si nxënës i shkollës së shurdhmemecëve”. Sarkazëm që me thënë të vërtetën tregon një ligësi të pabesueshme.

Pasi Anderseni u largua nga shtëpia e Dikensit (e ndjeu se s’ ishte më i mirëpritur, dhe qau edhe me rastin e largimit të tij), ai dërgoi një letër ku i kërkonte ndjesë. “Kini mirësinë të harroni” lutej, “aspektin e papëlqyer që jeta jonë së bashku mund të të ketë treguar për mua”. Vetë Dikensi, shkroi një shënim në pasqyrën e dhomës së mysafirëve: “Hans Andersen ka fjetur në këtë dhomë për

pesë javë, por familjes iu dukën SHEKUJ!”

Pavarësisht se të dy burrat me këto sjellje në mënyra të ndryshme s’dalin edhe aq të mëdhenj (Anderseni ishte jashtëzakonisht i ndjeshëm dhe Dikensi veçse tregohej i keq), kjo histori na kujton se ndërsa ndonjëherë edhe *mund* ta takosh heroin tënd...me adhuruesin tënd puna është krejt ndryshe dhe ndoshta thjesht s’duhet ta lejosh të jetoj me ty. Në shtëpinë tënde.

Revista letrare “Lithub”, mars 2020.

Përktheu: Granit Zela



Andersen në shtëpinë e Dikensit përjetoi gjendje të trazuar shpirtërore duke qarë pasi lexoi recensa të papëlqyeshme për veprën e tij. Fotografia: Getty images.

MËSIMET E HISTORISË

Një koleksion me ese të jashtëzakonshme të dy prej
mendimtarëve më të shquar të epokës sonë, të cilët
përmbledhin 5000 vjet histori në 100 faqe



FITUES TË ÇMIMIT PULITZER

WILL & ARIEL DURANT